



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## **RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë  
Bachelor në “Financë dhe Kontabilitet”  
Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Rezarta Perri

Prof. Asoc. Dr. Gentiana Sharku

Korrik/2020

# TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” është licencuar në vitin 2011 me Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 781, datë 10/11/2011. Në këtë vendim është licencuar me emërtimin Shkolla e Lartë Universitare Private “Instituti Kanadez i Teknologjisë”.

Me Urdhër Nr. 139, datë 25.03.2016 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit është bërë Akreditimi Institucional i Shkollës së Lartë Universitare Private “Instituti Kanadez i Teknologjisë” në përputhje me Vendimin Nr. 92, datë 02.11.2015 të Këshillit të Akreditimit. Në vitin 2017, Kolegji Universitar “IKT” është akredituar përsëri nga ASCAL në bashkëpunim me QAA (Agjencia Britanike e akreditimit) dhe ka marrë “Certifikatën e Akreditimit” prej Bordit të Akreditimit, me vendim Nr. 116, datë 15.12.2017, për një periudhë 5 vjeçare.

Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” është i organizuar nëdy Fakultete, ku secili është i organizuar në 2 departamente dhe një njësi shkencore. Këtë strukturë dhe emërtim e ka marrë me Urdhër të MAS, Nr. 556, datë 24.11.2016.

Në përbërje të Fakultetit të Ekonomisë ndodhen:

1. Departamenti Administrim Biznesi
2. Departamenti Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni
3. Njësia e Kërkimit Shkencor “CIRD Ekonomi”

Në përbërje të Fakultetit të Inxhinierisë ndodhen:

1. Departamenti i Inxhinierisë Softuerike
2. Departamenti i Inxhinierisë Industriale
3. Njësia e Kërkimit Shkencor “CIRD Inxhinieri”

Me urdhër Nr. 566, datë 12.12.2016, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në bazë të Vendimit nr. 195, datë 17.10.2016 të këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, është hapur programi i studimit të ciklit të parë “Bachelor në “Financë dhe Kontabilitet” në Fakultetin e Ekonomisë, të Shkollës së Lartë Universitare Private “Instituti kanadez i Teknologjisë”. Programi i studimit realizohet me 180 kredite, në formë studimi me kohë të plotë, në gjuhën angleze, me kohëzgjatje 3 vite/6 semestra, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në “Financë dhe Kontabilitet”. Ky program ofrohet nga Departamenti i Administrim Biznesit, në Fakultetin e Ekonomisë.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në datën 19.06.2019, në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017”, Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit Bachelor në "Financë dhe Kontabilitet", nëpërmjet shërbimit në AMS.

ASCAL nëpërmjet procedurave institucionale të përcaktuara ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të ekzaminuar dokumentacionin e përcjellë nga KU “IKT” për të kryer vizitën në ambjentet e institucionit dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Për programin bachelor në “Financë dhe Kontabilitet”, grupi i jashtëm i vlerësimit përfshin si më poshtë:

1. Prof. As. Dr. Rezarta Shkurti, pedagoge ne Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik, Departamenti i Kontabilitetit.
2. Prof. Asoc. Dr. Gentiana Sharku, pedagoge ne Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik, Departamenti i Financës.

Koordinator teknik në këtë procedure është ME. Renata Qatipi.

Pas komunikimit, ekspertëve të jashtëm ju vendos ne dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Pas një kohe në dispozicion të ekspertëve për të studiuar dokumentat dhe për të përpiluar pyetjet apo paqartësitë e tyre, u përcaktuan edhe datat e vizitave në institucion 10 dhe 11 Qershor 2020. Gjatë vizitave ekspertëve iu vendos në dispozicion një sallë mbledhjesh për të kryer të gjitha takimet sipas axhendës. I gjithë stafi akademik dhe administrativ i KU “IKT” u angazhua për t’iu përgjigjur kërkesave të grupit të jashtëm. Dokumentacioni shtesë i kërkuar nga ekspertët u vu në dispozicion në datën 12.06.2020.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve dhe specialistes së ASCAL, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standarteve dhe për cdo kriter që i referohet standartit për programin e studimit bachelor në “Financë dhe Kontabilitet”.

Në fund paraqiten pikat e dobëta, pikat e forta dhe rekomandimet për programin e studimit. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Më datë 07.07.2020, përmes sistemit AMS, dhe me shkresë zyrtare Nr. 86/5 Prot., Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm. Me datë 10.07.2020, KU CIT përcjell nëpërmjet AMS komentin “*CIT është plotësisht dakort me konkluzionet e këtij raporti. Sugjerimet e dhëna qëndrojnë dhe do të merren parasysh në vitin e ri akademik, me qëllim rritjen e cilësisë së programit të studimit*”.

Në këtë rast Draft Raporti kthehet ne Raport përfundimtar.

**Shënim:** Zgjatja e periudhës së vlerësimit të jashtëm, ka ardhur si pasojë e pandemisë së COVID-19. Komunikimi zyrtar me KU CIT është bërë vetëm nëpërmjet sistemit AMS, bazuar në Urdhërin e MSHMS Nr. 132 datë 09.03.2020, Urdhërin e MASR Nr. 91 date 09.03.2020, Urdhërin e MSHMS Nr. 190 datë 19.03.2020.

# Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Financë dhe Kontabilitet”

## I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë,” (referuar në vazhdim të këtij raporti vlerësimi si “KU CIT”), është një Institucion i Arsimit të Lartë i cili në misionin e përgjithshëm të tij (referuar Statuti i KU CIT, 2016, neni 4) synon vlerësimin dhe respektimin e diversitetit kulturor dhe vlerave të Shqipërisë. Aktualisht, KU CIT ofron programe studimi që përgatisin studentët në dy disiplina kryesore, në fushën e ekonomisë dhe atë të inxhinierisë. Në përputhje me vizionin e Institucionit (referuar Statuti i KU CIT, 2016, neni 4), synohet që tek këta studentë të nxiten vlerat etike si edhe mendimi kritik përtej edukimit të thjeshtë. Bazuar në këtë formulim, GVJ formon opinionin se programet e studimit të ofruara nga Institucioni nuk bien ndesh me vlerat morale në përgjithësi dhe me interesat kombëtare në mënyrë më specifike. GVJ konfirmon gjithashtu se Rregullorja Institucionale e KU CIT e vitit 2016, neni 7, përforcon vizionin dhe misionin e Institucionit të referuar në Statutin e tij.
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Rregullorja Institucionale e KU “IKT” 2016, neni 7, thekson që (në vijim citim nga kjo rregullore): “ <i>vizioni i Institucionit është përgatitja e studentëve me aftësi të mbështetura mbi edukimin, vlerat dhe shpirtin etik, mendimin kritik dhe atë analitik të orientuar drejt zgjidhjes së problemeve</i> ”. Si mision, përmendet ndër të tjera, nxitja e konkurrencës dhe përmirësimi i cilësisë së edukimit në shërbim të vlerave të shoqërisë me diversitet kulturor.“  GVJ konstaton se bazuar në vizionin dhe misionin e tij, Institucioni ka në fokus ruajtjen e vlerave akademike (kërkimi, cilësia, integriteti) dhe ato shoqërore (pranimi i larmisë dhe kulturës si etikë komunikimi).
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Nga shqyrtimi i Rregullores së Programit të Studimit Bachelor në Financë dhe Kontabilitet, GVJ vrojton se në pikën 1 të saj, deklarohet se ky program studimi është hartuar në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë 80/2015 dhe me Statutin dhe Rregulloret e Institucionit pra është hartuar në përputhje me misionin si dhe qëllimet e KU “IKT”. (shiko edhe Statuti i KU “IKT”, neni 4). Programi i studimit Bachelor në Financë dhe Kontabilitet, sic konfirmon Rregullorja e programit të studimit, ofrohet në përputhje me qëllimin dhe misionin e Institucionit (përgatitja e specialistëve në fushat e ekonomisë dhe inxhinierisë).

<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV, konstatohet se hapja e programit të studimit Bachelor në Financë dhe Kontabilitet është paraprirë nga një hulumtim i zhvillimeve ekonomike të Shqipërisë dhe prirjeve të tregut. Në vitin 2016, Institucioni ka realizuar një studim të tregut, pjesë e të cilës është analiza e brendshme, por edhe shqyrtimi i trendeve ndërkombëtare. Ndër gjetjet e këtij studimi ishte nevoja e konstatuar në tregun kombëtar për punonjës në fushën e Financës dhe Kontabilitetit si edhe identifikimi i punëdhënësve kryesorë në Shqipëri që ishin Institucionet Financiare dhe Bankat (Studimi i Tregut, faqja 21). Këto dy konstatime mbështesin kërkesën e tregut të brendshëm për studiues dhe profesionistë të dedikuar në sektorin e Financës dhe Kontabilitetit dhe formojnë tek GVJ opinionin se ky program studimi do të nxisë zhvillimin ekonomik duke pasuruar në sasi dhe cilësi tregun e profesionistëve financiarë dhe kontabël në Shqipëri.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.2</b>  <b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Ndër dokumentet më të rëndësishme pjesë e DVV të dorëzuar nga Institucioni, në të cilat përcaktohet strategjia e zhvillimit të institucionit dhe programeve të tij janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Strategjia e Zhvillimit të KU “IKT” 2024</li> <li>2. Plani Strategjik dhe Biznes-Plani i KU ICT, 2012</li> <li>3. Studimi i Tregut 2011” (Feasibility Study 2011).</li> </ol> <p>Pas shqyrtimit të këtyre tre dokumentave nga ana e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstatohet se programi i studimit paraqitet në përputhje me qëllimet dhe objektivat e institucionit, të përcaktuara në “Strategjinë e Zhvillimit” të tij.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Statutit të Institucionit GVJ konstaton se KU CIT ka identifikuar në mënyrë të qartë dhe transparente drejtimit prioritar akademike të tij, (neni 4, Statuti) si më poshtë citim:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a) <i>Ofrimin e arsimimit të lartë dhe veprimtarisë krijuese në fushën e inxhinierisë dhe të ekonomisë.</i></li> <li>b) <i>Zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike, që kryhet brenda dhe jashtë vendit;</i></li> <li>c) <i>Formimin e studiuesve të rinj në fushat teorike të vlerësimit, në fushën e inxhinierisë dhe të ekonomisë.</i></li> </ol>

	<p>d) Thëllimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistit të lartë në fushën e inxhinierisë dhe të ekonomisë.</p> <p>e) Kryerjen e studimeve kërkimore - shkencore për të zhvilluar e tejçuar aplikime dhe inovacione në fushat e kërkimeve të inxhinierisë dhe të ekonomisë.</p> <p>f) Ofrimi i mundësive më të mira për të përfituar nga arsimit i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës;</p> <p>g) Kontributi në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit”.</p> <p>GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Financë dhe Kontabilitet është i orientuar në përputhje me një të ngafushat akademike të identifikuar në pikën (a) më lart, dhe pikërisht me drejtimin e ekonomisë.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>Bazuar në shqyrtimin e Rregullores së Programit të Studimit, Planit Mesimor dhe dokumenta të tjerë në DVV, GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Financë dhe Kontabilitet” i ofruar nga KU CIT, është një program studimi i Ciklit të Parë me 180 kredite, me formë studimi me kohë të plotë, i ofruar dhe realizuar në gjuhën angleze, i organizuar me një kohëzgjatje normale 3 vite (6 semestra). Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë universitare Bachelor në “Financë dhe Kontabilitet” (Rregullorja e Programit Mësimor). Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të Programit të Studimit, GVJ arrin në përfundimin se programi është strukturuar dhe organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, sipas nivelit të kualifikimit të kërkuar në përputhje me Ligjin për Arsimit të Lartë dhe Kërkimin Shkencor, udhëzimet e Ministrit të Arsimit, Sportit e Rinisë (MASR) dhe sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Përmbajtja e programit të studimit është gjithashtu në përputhje me drejtimin akademik të KU CIT sic shprehet në Statutin e Institucionit dhe me planet strategjike sic paraqiten në “Planin Strategjik dhe Biznes-Planin” e vitit 2012 sipas të cilit parashikohej synimi për hapjen e një programi studimi në fushën e financës dhe kontabilitetit.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.3</b>  <b>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p> <p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet,</p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ana e Institucionit në faqen e ASCAL, GVJ konstaton se KU CIT ka kryer në vitin 2011 një studim të fizibilitetit për tregun dhe kërkesat për nevoja arsimore në Shqipëri (Studimi i tregut 2011- Feasibility Study 2011). Hapja e</p>

<p>aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Institucionit dhe lancimi i programit të studimit mbështeten në sugjerimet e këtij studimi sipas të cilit janë identifikuar kërkesat që ka tregu i punës për aftësi specifike që studentët duhet të kenë. Gjithashtu në Rregulloren e Programit të Studimit përcaktohen qartë objektivat e programit, aftësitë e synuara dhe kompetencat qëparashikohet të jenë të aftë të ushtrijnë studentët në përfundim të studimeve në këtë profil (Rregullorja e Programit të Studimit, faqe 2).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstaton dy studime të tregut, të cilat kanë qëllime dhe fokuse të ndryshme, si edhe janë kryer në kohë të ndryshme. Një studim paraprak fizibiliteti i kryer në vitin 2011 lidhet në mënyrë të përgjithshme me hapësirat që ofron tregu arsimor i lartë në Shqipëri (Studimi i Fizibilitetit, 2011); kurse një studim më i drejtpërdrejtë dhe i fokusuar i tregut është kryer në vitin 2016 (Studimi i tregut për hapjen e programit (Janar, 2016), pra para hapjes së programit të studimit (licensimi i të cilit, GVJ konstaton se është bërë në fund të vitit 2016). Nga shqyrtimi i studimit të tregut konstatohen të dhëna dhe gjetje, mbështetur në komunikimet me punëdhënësit potencialë kryesorë, të dhëna mbi potencialin e punësimit në të ardhmen, dhe analizë e zhvillimeve të pritshme jo vetëm në tregun shqiptar por edhe në atë global. I njëjti studim evidenton aftësitë dhe kompetencat kryesore me të cilat duhet të pajisen studentët e kësaj fushe. Studime të mëpasshme nuk janë kryer pasi nuk është diplomuar ende brezi i parë i studentëve në këtë program studimi.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve, garantojnë përfundimin e dijes, aftësi, shkathësi dhe kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Rregullores së Programit të studimit Bachelor në Financë dhe Kontabilitet, (faqja 2 e rregullores), GVJ konstaton se qëllimi i këtij programi është të pajisë studentët me njohuri bazë në fushat e Financës, Bankës, Kontabilitetit dhe Auditimit (në mënyrë të përgjithshme Financë – Kontabilitet). (Qëllimi i programit të studimit, Rregullorja e Programit të Studimit, faqja 2).</p> <p>Po ashtu, GVJ identifikon si aftësi të synuara të programit Bachelor në “Financë dhe Kontabilitet” sa më poshtë (citim nga Rregullorja e Programit të Studimit):</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Njohuri të përgjithshme dhe të plota mbi financimin e korporatave dhe organizimin e tregut, strukturën, instrumentet, produktet, shërbimet, si dhe institucionet financiare dhe bankare, buxhetin e qeverisë, sistemin e taksave dhe politikat ekonomike publike.</i></li> <li>• <i>Njohuri të përgjithshme dhe të plota mbi rregulloret financiare dhe ligjore të një veprimtarie afariste: inicimi, mbikëqyrja, rreziqet dhe administrimi i rreziqeve.</i></li> <li>• <i>Njohuri të përgjithshme në lidhje me përgatitjen, analizën dhe auditimin e bilanceve financiare, si dhe informacionin e kontabilitetit.</i></li> <li>• <i>Aftësi që lidhen me llogaritjen dhe vlerësimin e letrave me vlerë, performancën e kompanisë dhe investimet financiare dhe fizike.</i></li> <li>• <i>Shkathësi në fushën e administrimit, kontabilitetit dhe financimit për qeverisjen e çdo departamenti të një organizate, në lidhje me detyra të</i></li> </ul>

	<p><i>ndryshme si: kontrollues, menaxhim të thesarit, analizë të rrezikut, gjenerimin dhe mbylljen e raporteve të kontabilitetit, auditimin e llogarive brenda dhe jashtë, këshillimin e investimeve dhe financave.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li><i>• Aftësi shumë të mira menaxheriale në lidhje me aktivet e firmave dhe bankave, detyrimet, fitimet, kostot dhe financat, si dhe aftësitë specifike menaxheriale në lidhje me portofolet e investimeve.</i></li> <li><i>• Shkathtësi analitike që lidhen me pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, buxhetimin e ndërmarrjeve dhe projektet, kostot dhe përfitimet etj.(Rregullorja e programit të studimit).</i></li> </ul> <p>Bazuar në shqyrtimin e Planit Mësimor, Përmbajtjes së Kurrikulave dhe Syllabuseve të lëndëve të programit të studimit, si edhe në bazë të opinionit të formuar pas vizitës në Institucion, GVJ arrin në përfundimin se struktura dhe përmbajtja e programit të studimit janë në funksion të: 1. Objektivave formues të programit të studimit dhe 2. Aftësive të synuara të identifikuar për studentët e këtij programi.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p><b>Standardi I.4</b>  <b>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstaton se në KU CIT programet e studimeve organizohen sipas sistemit 3 + 2 të Kartës së Bolonjës. Pra, programet e studimeve të ciklit të parë Bachelor zgjasin 3 vite/180 ECTS. GVJ pasi shqyrtoi organizimin dhe strukturën e KU CIT (sipas Organigramës së KU “IKT” 2016) si edhe pas konstatimeve në vend gjatë vizitës në Institucion ku konstatoi ndryshime në staf, por ndryshime të një mase të tillë që nuk çenojnë kapacitetet dhe burimet e nevojshme, konfirmon që KU CIT është i organizuar në dy njësi kryesore 1) Fakulteti i Inxhinierisë dhe 2) Fakulteti i Ekonomisë. Është pikërisht ky i fundit, njësi kryesore përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Financë dhe Kontabilitet. Sipas konstatimeve, KU CIT ka 10 vite që operon dhe paraqitet se megjithë ndryshimet e fundit në staf, disponon kapacitete në burime njerëzore të mjaftueshme për të garantuar realizimin e objektivave të këtij programi studimi.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas</p>	<p>Njësia kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, Bachelor në Financë dhe Kontabilitet është Fakulteti i Ekonomisë i KU CIT. Gjatë vizitës në Institucion, drejtues të tij u shprehën se Fakulteti i Ekonomisë (FE) i është nënshtruar disa ndryshimeve, që kanë pasur për qëllim konsolidimin më të mirë të programeve të studimit, diplomave dhe kurrikulave përkatëse si edhe optimizimin e ofrimit të shërbimeve akademike dhe kërkimore. GVJ konstaton se fusha e përgjithshme dhe</p>



direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit.			
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Sipas Organogramës së Institucionit, (pjesë e dokumentacionit në DVV), Fakulteti i Ekonomisë i KU CIT që është edhe njësi kryesore përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit është i organizuar në dy departamente dhe një njësi të kërkimit shkencor: (1) Departamenti i Administrim Biznesit dhe (2) Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit dhe (3) Njësia e Kërkimit Shkencor CIRD Ekonomi. Programi i studimit Bachelor në Financë dhe Kontabilitet është përgjegjësi pikërisht e Departamentit të Administrim Biznesit, si njësi bazë.</p> <p>Pra përmbush kërkesat minimale. Programi i studimit Bachelor në Financë dhe Kontabilitet ofrohet në përputhje me fushën akademike kërkimore dhe akademike të njësisë bazë, (Departamenti i Administrim Biznesit) dhenga GVJ konstatohet se numri dhe formimi i personelit akademik të angazhuar në këtë njësi bazë siguron përgatitjen adekuate të studentëve të këtij programi studimi.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.5</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Sikurse është shprehur edhe më lart në këtë raport, përgjegjësia e drejtpërdrejtë për kryerjen dhe realizimin e objektivave të programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet në KU CIT, është e Departamentit të Administrim Biznesit. Sipas tabelës 1 në RVB të KU CIT, konstatohet nga ana e GVJ se në mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit Bachelor në “Financë dhe Kontabilitet” angazhohet jo vetëm stafi akademik i Departamentit të Administrim Biznesit, por edhe staf akademik i brendshëm nga Departamentet e tjera, por dhe nga Fakulteti i Inxhinierisë për lëndë si Matematika apo Informatika. Ky bashkëpunim reciprok u konfirmua edhe gjatë vizitës në Institucion në kontaktet që GVJ pati me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit. Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar, GVJ u ndal në Raportin për vlerësimin e programit (për vitin akademik 2018-2019; dokumenti 89 në DVV), i cili përpilohet në përfundim të vitit akademik dhe paraqet në mënyrë të përmbledhur përmbushjen e pritshmërive, si dhe pengesat që ka pasur përgjatë vitit. Në këto raporte GVJ konstaton në nivel të kënaqshëm të analizës së punës së bërë me programin e studimit.</p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar dhe sipas konfirmimeve të kryera pas vizitës në Institucion, GVJ konstaton se institucioni ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe si edhe me partnerë brenda dhe jashtë vendit. Këto marrëveshje synojnë të mundësojnë mobilitetin e stafit dhe studentëve (KU CIT është pjesë e mobiliteteve Erasmus +, Mevlana dhe CEEPUS - dokumentet nr 64,65, 66 në Dosjen e VV, dhe në shtojcën e RVB të Institucionit në tabelën nr. 28), si edhe mundësinë e praktikave dhe internshipeve për studentët (tabela 5 në Shtojcën e RVB liston bizneset me të cilat KU CIT ka marrëveshje).</p> <p>Gjithashtu GVJ konstaton një sërë marrëveshjesh me Institucione të ngjashme (dokumentat 6 – 10 në dosjen e VV) qëllimi i të cilave (sipas raportimit në RVB) është pjesëmarrja në projekte, konferenca dhe tryeza ku mund të përfshihet stafi dhe studentët.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se KU CIT përfshin në Raportin Institucional Vjetor (për MASR 2018-2019, ishte viti i fundit i dorëzuar) të dhëna të detajuara dhe të përpunuara mbi mobilitetin studentor dhe atë të stafit akademik. NjëkëtëRaport, GVJ konstaton një larmi aktiviteteve të realizuara si fryt i bashkëpunimit me partnerët, por jo të gjitha kanë qenë me interes për përfshirjen e studentëve të këtij programi studimi, Bachelor në Financëdhe Kontabilitet.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>GVJ konstaton se KU CIT ka marrëdhënie zyrtare dhe bashkëpunon me biznese dhe punëdhënës potencialë për t'i dhënë mundësinë studentëve të kryejnë praktikat mësimore. Konstatohet gjithashtu se në vitin akademik 2019 – 2020 Institucioni ka hartuar Manualin e Praktikës Mësimore (dokumenti 25 nëDVV) si dokument udhëzues për vetë studentët. Mbështetur në kontaktet me studentët e programit të studimit, gjatë vizitës në Institucion, GVJ kontstaton se programi i praktikave është duke u kryer dhe ka pasur rezultatet të kënaqshme për studentët e programit të studimit.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>N/A për shkak se Institucioni nuk ka diplomuar ende student për këtë program specifik studimi. Në kohën e kryerjes së vlerësimit nga GVJ (qershor 2020), Institucioni është në prag të diplomimit të studentëve të brezit të parë të programit të studimit Bachelor në Financëdhe Kontabilitet.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>
--	------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	---

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Financë dhe Kontabilitet i ofruar në KU CIT, është i organizuar në lëndë e module të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi (Ligji për Arsimin e Latë 80/2015) dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Totali i krediteve që studenti duhet të grumbullojë në përfundim të programit të studimit është 180 ECTS. Programi është me kohë të plotë dhe mësimdhënia është në gjuhën angleze, me një kohëzgjatje 3 vjet / 6 semestra në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në “Financë dhe Kontabilitet”. (Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në “Financë dhe Kontabilitet”)</p> <p>Të gjitha disiplinat mësimore të ofruara në kategoritë A, B, E C, D dhe E janë të detyrueshme dhe të vlerësuara me 6 kredite.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor të Programit të Studimit, GVJ konstaton se disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në programin e studimit Bachelor në Financë Kontabilitet janë të organizuara në 5 kategori, nga A në E, në përputhje me VKM nr. 41.</p> <p>GVJ konstaton se fusha e lëndëve të përfshira në programin e studimit ka një mbulim të konsiderueshëm të disiplinave specifike Financë dhe Kontabilitet dhe ofron larmi të përfitimit të njohurive përkatëse duke përfshirë teknikat e mbajtjes së kontabilitetit dhe raportimit financiar të njësive ekonomike, njohuri bazë të sistemit financiar dhe ndërlidhjen e aktorëve të sistemit financiar dhe vecanti të sistemit kontabël në vendin tonë i cili është specifik përsa i përket rregullimeve.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	<p>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të Programit të Studimit dhe më tej të Syllabuseve të Lëndëve, GVJ konstaton se në tërësi ky program jep njohuri të kompletuara teorike dhe akademike në fushat e studimit Financë dhe Kontabilitet dhe i aftëson studentët për punësim të mëtejshëm. Lëndët e ofruara në këtë program kanë një kombinim të mirë mes parimeve dhe koncepteve teorike dhe atyre akademike të fushave përkatëse.</p>
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	<p>Sipas Planit Mësimor të studimit Bachelor në Financë dhe Kontabilitet, GVJ konstaton se në vitin e parë të studimeve, kryesisht programi i studimit ofron disiplina të formimit të përgjithshëm dhe atij bazë të kategorisë A dhe B. Gjatë vitit të dytë dhe të tretë të studimeve, studenti thëllon njohuritë dhe aftësitë në fushën e studimit me lëndë të kategorisë B dhe D, si edhe plotëson interesat e tij të veçanta studimore në lëndët me zgjedhje të kategorisë C.</p> <p>Mbështetur në analizën e syllabuseve të lëndëve të programit, dhe sidomos në kontaktet me studentët e programit, GVJ formoi opinionin se studentët nxiten të fitojnë aftësi dhe kompetenca për problem zgjidhje jo konvencionale dhe të</p>

	sofistikuara dhe ndjeheshin të gatshëm dhe të aftë të përballëshin me sfidat e tregut të punës.			
<b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV, sidomos Rregullores së Programit të Studimit Bachelor në “Financë dhe Kontabilitet”, Planit Mësimor dhe Syllabuseve të lëndëve, GVJ konstaton se ky program studimi përmban elementët e kërkueshëm strukturorë.</p> <p>Ai është i organizuar në pesë disiplina formuese, ka 180 kredite, zgjat tre vite akademike dhe frekuentimi i procesit mësimor (leksione/ushtrime/ seminare /laboratorë/projekte/ punim i diplomës) është i detyrueshëm në masën 75%. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit në KU CIT mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm.</p> <p>Syllabuset janë kryesisht në përputhje me aktet ligjore dhe konkretisht VKM nr.41 (viti 2018), me përjashtim të elementit të detajimit të çështjeve sipas javëve mësimore, shoqëruar me nën-çështje të detajuara dhe literaturën përkatëse. Shtojca 2 e VKM nr.41 kërkon që çështjet të jenë të detajuara me nën-çështje dhe literaturën përkatëse por GVJ konstaton se kjo nuk është zbatuar në mënyrë uniforme për të gjitha programet lëndore.</p>			
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	<p>Sic konfirmohet nga shqyrtimi i Planit Mësimor të programit të studimit, shpërndarja e lëndëve dhe moduleve sipas kategorive, në ECTS për programin e studimit është si më poshtë:</p> <p><i>Sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar, ndarja në kategoritë është si më poshtë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kategoria A (lëndët e formimit të përgjithshëm /bazë): 36 ECTS (20%)</li> <li>- Kategoria B (lëndët e formimit karakterizues: 90 ECTS (50%)</li> <li>- Kategoria C (lëndë ndërdisiplinore, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje): 30 ECTS (16.6%)</li> <li>- Kategoria D (lëndë plotësuese dhe praktika profesionale): 18 ECTS (10%)</li> <li>- Kategoria E (detyrimet përmbyllëse/mbrojtja e temës së diplomës): 6 ECTS (3.3%)</li> </ul> <p>Numri i përgjithshëm i disiplinave (të thjeshta ose të organizuara në module) të nevojshme për t'u diplomuar, së bashku me praktikën profesionale dhe punimin e diplomës, është 31.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e	Mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar në DVV, KU CIT është akredituar si institucion në vitin 2017 nga ASCAL (dokumenti nr.15 në DVV). Baza e

<p>studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>funksionimit të Fakultetit të Ekonomisë të KU CIT që është edhe njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Financë dhe Kontabilitet është ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe Statuti dhe Rregullorja e Institucionit.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë ofron në total 6 programe, nga të cilat 3 janë të ciklin e parë dhe 2 në ciklin e dytë të studimit. Në Departamentin e Administrim Biznesit që është njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit që po vlerësohet, ofrohen dy programe në ciklin e parë dhe dy në ciklin e dytë. Të gjitha programet e ofruara prej Fakultetit të Ekonomisë janë të akredituar përveç programit që po vlerësohet aktualisht nga GVJ.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësive përkatëse.</p>	<p>Drejtimi organizativ e akademik i departamentit bëhet nga Përgjegjësi i Departamentit (referuar dokumenti: Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë,) i cili ka gradë PhD, ndërsa koordinatori i programit të studimit (sipas vendimit të datës 6.1.2020 nga Dekani i Fakultetit të Ekonomisë, dok nr 94 në DVV) është caktuar gjithashtu personeli i cili ka gradën PhD. Para caktimit të koordinatorit të programit të studimit, ky rol është luajtur nga përgjegjësi i departamentit (sipas konfirmimeve në institucion). Në Rregulloren e Përgjithshme Institucionale, përshkruhen përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të programit të studimit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstatohet se Koordinator i programit ka qene vete shefi i departamentit deri ne Janar 2020. Ne Janar eshte caktuar nje koordinator i ndryshem nga shefi i departamentit dhe per kete periudhe te shkurter (janar-qershor) nuk jane bere informime me shkrim, por komunikime dhe informime jo zyrtare te vazhdueshme.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Mbështetur në kërkesat e nenit 23 të ligjit të A.L "Fakulteti organizohet në së paku tri njësi bazë, së paku dy prej të cilave janë departamente", GVJ konfirmon se Fakulteti i Ekonomisë i KU CIT përbëhet nga tre departamente/njësi bazë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Departamenti i Administrim Biznesit (BA)</li> <li>- Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit (BA &amp; IT) dhe</li> <li>- Njësia e Kërkimit Shkencor "CIRD-Ekonomi".</li> </ul> <p>Referuar të dhënave të dorëzuara në RVB si edhe konfirmimit gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Administrim Biznesit përmbush kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit (min 7 pedagogë të brendshëm /3 me tituj/grada).</p> <p>Kështu, në vitin akademik <b>2019-2020</b> stafi akademik ka këto të dhëna:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 7 pedagogë me kohë të plotë (1 Prof.Dr; 1 Prof.As; 3 Dr. 2 MSc)</li> <li>- 1 me kohë të pjesshme. (1 MSc)</li> </ul> <p>Në vitin akademik <b>2018-2019</b> stafi akademik ka këto të dhëna:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 7 pedagogë me kohë të plotë (1 Prof.Dr; 1 Prof.As Dr; 1 Dr.; 2 studentë të doktoraturës dhe 2 MSc)</li> <li>- 1 me kohë të pjesshme (1 Prof.As Dr).</li> </ul>

	<p>Në vitin akademik <b>2017-2018</b>stafi akademik ka këto të dhëna:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 7 pedagogë me kohë të plotë (1 Prof.Dr; 1 Prof.As Dr; 1 Dr.; 1 studente e doktoraturës dhe 3 MSc)</li> <li>- 2 me kohë të pjesshme(1 Dr dhe 1 MSc).</li> </ul>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Referuar shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar (tabelat në RVB dhe verifikim gjatë vizitës në Institucion), GVJ konstaton se Fakulteti i Ekonomisë KU CIT përmbush kriterin për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p> <p>Kështu, referuar dokumentacionit të dorëzuar, në vitin e fundit akademik 2019-2020, Fakulteti i Ekonomisë, i KU CIT nga 26 staf gjithsej, ka 22 pedagogë me kohë të plotë (pra 84.6% të stafit total), dhe 4 pedagogë me kohë të pjesshme.</p> <p>Pjesë e stafit të brendshëm PAE janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 2 Prof.Dr;</li> <li>- 5 Prof.As.Dr;</li> <li>- 7Dr;</li> <li>- 8 Msc (1 Dr. ne proces)</li> </ul> <p>Në stafin e jashtëm janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 1 Prof.As.Dr,</li> <li>- 3 Msc (1 Dr. ne proces)</li> </ul> <p><b>Në vitin akademik 2018-2019</b> Fakulteti i Ekonomisëka patur 21 pedagogë me kohë të plotë (87.5% të totalit), dhe 3 pedagogë me kohë të pjesshme.</p> <p>Në totalin e stafit të brendshëm janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 2 Prof.Dr;</li> <li>- 4 Prof.As.Dr;</li> <li>- 4 Dr;</li> <li>- 11 Msc (3në Dr ne proces)</li> </ul> <p>Në stafin e jashtëm janë: 1 Prof.Dr, 1 Prof.As.Dr, dhe 1 MSc.</p> <p><b>Në vitin akademik 2017-2018</b> Fakulteti i Ekonomisëka 21 pedagogë me kohë të plotë (84% të totalit), dhe 4 pedagogë me kohë të pjesshme. Në totalin e stafit të brendshëm janë 2 Prof.Dr; 2 Prof.As.Dr; 5 Dr; 2 studentë të doktoraturës dhe 10 MSc. Në stafin e jashtëm janë 1 Prof.As.Dr, 2 Dr dhe 2 MSc.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi II.3**  
**Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Bazuar në diskutimet e kryera me pedagogët dhe studentët e programit të studimit gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se në përgjithësi informacionet për elementet e rëndësishme të programeve të studimeve janë publike dhe të mundshme për t'u aksesuar lirisht. Sipas rregullores së Institucionit, Plani Mësimor i programit të studimit miratohet me propozim të Fakultetit dhe njësisë bazë në Senatit Akademik për secilin vit dhe u shpërndahet njësisë kryesore, atyre bazë, stafit akademik, atij administrativ dhe i bëhet i ditur studentëve. GVJ konstatoi se një kopje e Planit Mësimor gjendet edhe në faqen e internetit.</p> <p>Në fillim të cdo semestri studentëve iu vihen në dispozicion dhe ju prezantohen syllabuset për cdo lëndë që ofrohet. (Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në “Financë dhe Kontabilitet”, fq. 4-5.)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në shqyrtimin e Planit Mësimor të Programit të Studimit Bachelor në Financë Kontabilitet në KU CIT, GVJ konstaton se programi i studimit është i organizuar në module të detyrueshme dhe lëndëme zgjedhje, praktikë e aktivitete formuese sipas kërkesave të ligjit nr. 80/2015 për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>GVJ konstaton se organizimi i veprimtarisë mësimore të programit të studimit Bachelor në Financë dhe Kontabilitet në KU CIT bëhet në tre vite ku secili ka dy semestra me kohëzgjatje normale 15 javë. Pra programi shtrihet në 6 semestra, në të cilin praktika mësimore dhe mbrojtja e temës së diplomës bëhen në përfundim të semestrit të 6-të.</p> <p>Ndarja në kredite/kategori është dhënë në kriterin 6/standardi II.1</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Planit mësimor të programit të studimit (dok nr. 48 në DVV), GVJ konstatoi se ky dokument jep informacion në lidhje me ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit. Përsa i përket elementeve të tjera: frekuentimi /ndjekja e programit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve, vërejmë se Institucioni i specifikon ato në “Vlerësimi i Studentit” (Student Evaluation - Libri i rregulloreve Institucionale, “Mbi vlerësimin e studentit” (Student Evaluation), fq. 55). Bazuar në këtë rregullore vlerësimi i dijeve gjatë vitit bëhet në një format të përgjithshëm si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 10 % aktivizimi dhe ushtrimet në klasë</li> <li>- 20% provimi i ndërmjetëm</li> <li>- 40% plotësimi i detyrimeve (kuize, studime rasti, detyra projekte kursi)</li> <li>- 30% provimi përfundimtar</li> </ul> <p>Gjatë hartimit të syllabuseve specifike, pedagogëve u lihet liri që të ndryshojnë deri në 20% të kufijve të mësipërm të vlerësimit të dijeve gjatë vitit.</p> <p>Për frekuentimin e studentëve IAL ka vendosur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për leksionet detyrimi është 75%</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Për seminarët detyrimi është 75%</li> <li>- Për praktikat/laboratorët 75% (Rregullorja e Programit të Studimit, pika 6)</li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Përsa i përket pranimeve në programin e studimit Bachelor në Financë dhe Kontabilitet, KU CIT në rregulloren e Programit të Studimit, pika 2 parashikon se gëzojnë të drejtën e pranimit në këtë program studimesh, ata kandidatë të cilët zotërojnë një diplomë të shkollës së mesme me mesatare aritmetike jo më pak se 6.5; dhe notë të gjuhës angleze (në Maturën Shtetërore) jo më të ulët se 6 (apo kanë mbrojtur anglishten me një nga provimet e njohura). Në lidhje me transferimet apo / dhe ekuivalentimet e studimeve në KU CIT, GVJ pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar (Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë, fq.12.) dhe mbështetur edhe në intervistat e kryera gjatë vizitës në Institucion konfirmon procedurën e përshkruar në RVB e dorëzuar nga Institucioni. Pra, institucioni pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera të larta, vendase ose të huaja, publike ose jopublike dhe lejon transferimin e studentëve të saj në shkolla të tjera të larta dhe për cdo rast ka parashikuar procedurë të detajuar.</p> <p>Konfirmuar pas vizitës në Institucion, për këtë program studimi, për tre vitet që ka qenë i hapur, nuk ka pasur transferime në hyrje, ndërkohë që ka pasur tre student të transferuar në dalje.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabusët e detajuar) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Plani mësimor i Programit të Studimit si edhe programet lëndore përkatëse janë pjesë e dokumentacionit të shqyrtuar nga ana e GVJ. Referuar të dhënave marrë gjatë vizitës në Institucion si edhe RVB, syllabusët e lëndëve në KU CIT miratohen në fillim të cdo viti akademik nga përgjegjësi i departamentit dhe nga dekani dhe u bëhen të ditur studentëve dhe të gjithë stafit akademik e mbështetës në javën e parë të studimeve (kjo njihet si “java orientuese”), dhe me mënyra të tjera (faqja e internetit, komunikimi elektronik, etj).</p> <p>GVJ konstaton se syllabusi i cdo lënde përcakton edhe mënyrën e vlerësimit që ndjek çdo pedagog. Nota përfundimtare është rezultante e elementëve të vlerësimit: Provimet + detyra kursi/projekte individuale + pjesëmarrja aktive në procesin mësimor.</p> <p>Ndarja e peshës mes këtyre elementëve është e përcaktuar në Rregulloren e programit të studimit dhe në dokumentin “Student Evaluation” por cdo pedagogu i lihet një hapësirëderi 20% për përshtatjen e tyre sipas specifikave të cdo lënde.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Sipas RVB të shqyrtuar nga GVJ, Njësitë Kryesore ose Bazë dhe konkretisht Departamenti i Administrimit Biznesit, që është përgjegjës për programin e studimit që po akreditohet, përpunojnë dhe analizojnë informacionin e domosdoshëm përpara se të nisë viti akademik. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, stafi akademik i programit konfirmon faktin që syllabusët e programit të studimit nuk kanë pasur ndryshime nga ato të dorëzuara gjatë licencimit, por kanë pasur përshtatje modeste për të ardhur më pranë kërkesave të studentëve, por edhe për të përfshirë elemente që janë gjykuar të domosdoshme nga pedagogë të lëndëve të caktuara.</p>



	Në përgjithësi, GVJ konstaton mes stafit akademik një frymë mbizotëruese në funksion të përmirësimit dhe rritjes së cilësisë së ofrimit të programit të studimit.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi II.4**  
**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Ligji nr. 80/2015 për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, neni 73 pika 1, kërkon që programet e ciklit të parë të studimit, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohen me jo më pak se 180 krediteeuropiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike. GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet në KU CIT është hartuar dhe organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, e shtrirë në tre vite akademike me nga 60 ECTS, pra 180 ECTS në total.
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Sipas dokumentacionit të dorëzuar nga Institucioni, programi i studimit Bachelor në “Financë dhe Kontabilitet” <i>synon t’i pajisë studentët me aftësi të përparuara, që demonstrojnë kompetenca të kërkuara për të zgjidhur probleme në një fushë të specializuar pune ose studimi.</i> Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve, GVJ shprehet se aftësitë dhe kompetencat e përfshira në programet lëndore mundësojnëpajisjen e studentëve me aftësi për t’u punësuar në treg. Këto aftësi dhe njohuri konfirmohen me vetëbesim edhe nga studentët e programit të studimit, gjatë bisedave që GVJ zhvilloi me ta. Nga ana tjetër, fakti që studimet ofrohen në gjuhën angleze, lehtëson mundësitë e punësimit të studentëve edhe në tregun e punës jashtë vendit, por edhe në institucione ndërkombëtare që operojnë në vendin tonë.
<b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimi profesional.	Nga shqyrtimi i Planit mësimor i programit të studimit, GVJ konstaton se shpërndarja e ngarkesës mësimore në tre vitet është përgjithësisht e balancuar dhe lë hapësira për kombinim e duhur teoriko-praktik të njohurive mësimore. Po kështu, është e mundur arritja e objektivave formuese të programit të studimit të cilat, sipas Rregullores së Programit të Studimit janë “pajisja e studentëve me aftësi të përparuara, që demonstrojnë kompetenca të kërkuara për të zgjidhur probleme në disiplinën e “Financë dhe Kontabilitet”.
<b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e	GVJ shqyrtoi me prioritet syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit Bachelor në Financë dhe Kontabilitet të KU CIT dhe konstaton se këto lëndë ofrojnë nivel kryesisht të kënaqshëm në përputhje me profilin e programit si edhe në ngjashmëri me programe ndërkombëtare të kësaj discipline.

<p>përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Nga plani mësimor i paraqitur rezultojnë këto orë mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 850 orë leksione</li> <li>- 456 orë seminare</li> <li>- 322 orë ushtrime</li> <li>- 36 orë laboratore</li> <li>- 4 orë projekte</li> <li>- 120 orë praktike</li> <li>- 150 orë teza</li> </ul> <p>Raporti <b>Teori</b>(leksione) /<b>Praktikë</b>(sem+usht+proj+prakt prof) rezulton <b>850 ore/938 ore, ose afërsisht 1:1</b></p> <p>Në mënyrëmëspecifike, GVJ konstaton se programi mësimor mund të përmirësohet duke pasur parasysh disa elemente:</p> <p>1) të ketë një zgjerim të njohurive të disiplinës së kontabilitetit aplikativ, sidomos në pikëpamjen e kontabilitetit të informatizuar (për më tepër që sipas intervistave me stafin akademik, përqsja e financës me teknologjinë e informacionit ishte pjesë e vizionit të Institucionit);</p> <p>3) rishikimin për mënjanimin e mbivendosjeve mes disa lëndëve të disiplinës financiare, përkatësisht: Tregje financiare, Instrumente financiare, Investime.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Mbështetur në intervistat e kryera me studentët e programit, GVJ konstaton se aftësimi i studentëve dhe formimi i tyre teorik dhe praktik mundëson kryesisht arritjen e objektivave formues, transferimin e studimeve si edhe punësim në përfundim të studimeve.</p> <p>Praktika mësimore prej 4 javësh në semestrin e fundit, ndihmon studentët në përqsjen afër tregut të punës. Pothuajse të gjithë studentët e vitit të fundit të cilët ishin duke zhvilluar praktikën mësimore, u shprehën entuziastë për përshtatjen e shpejtë me punën në njësitë ekonomike ku ishin caktuar. Një nga elementet që studentët shprehën nevojë për t'u thelluar më shumë ishin koncepte ngalegjislacioni tatimor në vendin tone dhe në këtë kontekst mund të bëhet një pasurim i metejshëm i ceshtjeve të mbuluara në lëndën përkatëse (Taksimi).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i bërë për syllabuset, konstatojmë që ky kriter përmbushet kryesisht, me përjashtime të vogla në disa prej lëndëve të cilat kanë nevojë të rishikohen.</p> <p>Sugjerojmë përditësimin e këtyre teksteve, për të cilat libraria online McGrawHill me të cilën institucioni ka marrëveshje, disponon tituj të përmirësuar të pesë viteve të fundit.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Bazuar në analizën që GVJ i bëri tërësisë së syllabuseve të programit të studimit për të tre vitet arrin në përfundimin se në përgjithësi përmbajtja e tyre mundëson kryesisht përfitim të dijeve dhe aftësive nga ana e studentëve të kompetencave teknike të synuara për një program të ciklit të parë. Përsa i përket aftësive teknike në profesion, syllabuset e lëndëve të</p>

	këtij programi studimi paraqiten kryesisht të kompletuara, me disa përjashtime që nuk çënojnë vlerën totale të përmbajtjes së programit (referojuni konstatimeve të listuara në kriterin 4 më lart).			
<b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	<p>Bazuar në analizën që GVJ i bëri syllabuseve të programit të studimit për të tre vitet konstaton se në vija të përgjithshme përmbajtja e programit të studimit mundëson si vijimin e mëtejshëm të studimeve (në programe brenda dhe jashtë vendit), ashtu edhe punësimin e menjëhershëm të studentëve.</p> <p>Megjithatë, në elemente të veçanta, programi ka nevojë të pasurohet në përmbajtjen e syllabuseve të lëndëve që ofron, me fusha dhe tematika të cilat konsiderohen të rëndësishme për përfitim të kompetencave profesionale.</p> <p><u>Lëndët në fushën e finances si “Hyrje në finance”, “Financat e institucioneve dhe tregjeve”, “Tregjet financiare”, “Manaxhimi i riskut financiar”, “Investime” kanë përsëritje për sa i përket disa koncepteve që shpjegojnë.</u></p> <p><u>Lënda “Metoda kërkimi në finance” jemi të mendimit se është shumë e avancuar për studentët e ciklit të parë bachelor. Ajo mund të zhvillohet në ciklet e dyta të studimeve.</u></p> <p>Gjithashtu, do të listonim edhe njëherë: çështje që kanë të bëjnë me njohuri specifike të legjislacionit tatimor në vendin tonë, njohuri të kontabilitetit të informatizuar, dhe/ose njohuri të përgjithshme të menaxhimit të njësive ekonomike. Këto elemente do të përgatisnin edhe më shumë studentët si për tregun e punës ashtu edhe për vijimin e mëtejshëm të studimeve.</p>			
<b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Referuar deklarimeve të Institucionit në RVB, nisur nga feedback-u i studentëve, pjesë e procesit të praktikave mësimore, si dhe nga takimet dhe rekomandimet e ofruara prej aktorëve të rëndësishëm të tregut e institucioneve të fushës, syllabuset (programet) përkatëse të lëndëve/moduleve, përmirësohen duke synuar përshtatjen sa më të mirë të njohurive e aftësive teorike me ato praktike të kërkuara në tregun e punës. Kjo konfirmohet edhe nga intervistat e kryera gjatë vizitës në Institucion. Fryma e përmirësimit të vazhdueshëm karakterizonte stafin akademik të këtij programi studimi.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e	Sic është referuar në raportin VV dhe në Tabelat me të dhëna, stafi akademik i përfshirë në mësimdhënie në programe studimit Bachelor në “Financë dhe Kontabilitet” është më poshtë:

<p>programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>GJITHSEJ për vitin akademik <b>2019 – 2020</b> kanë dhënë mësim <b>15 pedagogë</b>ngatë cilët 13 PAE dhe 2 PAK (86%/14%)</p> <table border="1" data-bbox="817 226 1313 483"> <thead> <tr> <th><u>PAE:</u></th> <th><u>PAK:</u></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1 Prof.Dr</td> <td>1 Prof.As.Dr</td> </tr> <tr> <td>2 Prof.As.Dr</td> <td>1 Msc</td> </tr> <tr> <td>6 Dr/PhD</td> <td></td> </tr> <tr> <td>4 Msc</td> <td></td> </tr> </tbody> </table> <p>GJITHSEJ për vitin akademik <b>2018- 2019</b> kanë dhënë mësim <b>13 pedagogë</b>ngatë cilët 12 PAE dhe 1 PAK (92% / 8%):</p> <table border="1" data-bbox="817 607 1313 815"> <thead> <tr> <th><u>PAE:</u></th> <th><u>PAK:</u></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2 Prof.As.Dr</td> <td>1 Prof.As.Dr</td> </tr> <tr> <td>5 Dr/PhD</td> <td></td> </tr> <tr> <td>5 Msc</td> <td></td> </tr> </tbody> </table> <p>GJITHSEJ për vitin akademik <b>2017- 2018</b> kanë dhënë mësim <b>10 pedagogë</b>ngatë cilët 10 PAE (100%/0%).</p> <table border="1" data-bbox="817 943 1313 1151"> <thead> <tr> <th><u>PAE:</u></th> <th><u>PAK:</u></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2 Prof.As.Dr</td> <td></td> </tr> <tr> <td>4 Dr/PhD</td> <td></td> </tr> <tr> <td>4 Msc</td> <td></td> </tr> </tbody> </table> <p>Pra në të tre vitet PAE ka plotësuar kriteret ligjore duke qenë mbi 70%, në mësimdhënie</p>	<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>	1 Prof.Dr	1 Prof.As.Dr	2 Prof.As.Dr	1 Msc	6 Dr/PhD		4 Msc		<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>	2 Prof.As.Dr	1 Prof.As.Dr	5 Dr/PhD		5 Msc		<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>	2 Prof.As.Dr		4 Dr/PhD		4 Msc	
<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>																										
1 Prof.Dr	1 Prof.As.Dr																										
2 Prof.As.Dr	1 Msc																										
6 Dr/PhD																											
4 Msc																											
<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>																										
2 Prof.As.Dr	1 Prof.As.Dr																										
5 Dr/PhD																											
5 Msc																											
<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>																										
2 Prof.As.Dr																											
4 Dr/PhD																											
4 Msc																											
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>GVJ shqyrtoi të dhënat e personelit akademik të angazhuar në realizimin e programit të studimit dhe konstaton se fokusi profesional dhe formimi e niveli akademik i tyre është i kënaqshëm për të garantuar mbulimin e programeve dhe moduleve mësimore të programit të studimit. Cfarë konstatohet nga GVJ dhe konfirmohet nga stafi akademik, është numri i lartë i lëndëve mësimore për disa anëtarë të stafit akademik (disa prej tyre janë të angazhuar në 5 – 6 lëndë gjatë vitit akademik por gjithmonë duke ruajtur kufijtë e ngarkesës mësimore vjetore për pedagog). Pyetur për këtë, gjatë vizitës në Institucion, GVJ-së iu sqarua se kjo është bërë për të arritur optimizimin e shpërndarjes së ngarkesës mësimore, në kushtet kur numri i studentëve për klasë është i vogël.</p> <p>Vetë pedagogët u shprehën se caktimi i lëndëve mësimore është bërë me dakordësinë e tyre.</p>																										
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit,</p>	<p>GVJ shqyrtoi dosjet dhe CV e personelit akademik të angazhuar me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme dhe konstaton se pedagogët që janë të angazhuar në lëndë të këtij programi mësimor kanë formimin e duhur por edhe përvojën për të dhënë mësim në ato lëndë të cilat u janë ngarkuar. Ata janë të kualifikuar dhe punojnë në fusha akademike – kërkimi në</p>																										

natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të vecanta.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Dokumentacioni i dorëzuar nga Institucioni tregon se KU CIT, ka disa marrëveshje të nënshkruara me biznese të ndryshme me qëllim kryerjen e praktikave mësimore. GVJ, gjatë vizitës në Institucion konfirmoi mënyrën e funksionimit të Zyrës së Shërbimit të Studentëve qëllimi i së cilës është përgatitja e studentëve për procesin e praktikave profesionale si edhe funksionimin e rolit të koordinatorit për praktikat mësimore që ishte caktuar nga Institucioni.  Në lidhje me punimin e temës së diplomës KU CIT ka një procedurë të mirëpërcaktuar të cilën e përshkruan në RVB dhe të cilin GVJ e konfirmoi gjatë vizitës në terren. Gjatë vizitës në Institucion (qershor 2020), GVJ u informua se studentët kishin kohë që punonin për përgatitjen e punimit të diplomës. Temat dhe udhëheqësit ishin caktuar në muajt janar-shkurt 2020.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Orët mësimore të programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet ofrohen kryesisht në klasa të pajisura në mënyrë të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor (tabela shënimesh, projektor, kompjuter PC në cdo sallë). KU CIT ka në dispozicion të studentëve 4 laboratorë informatike për qëllime mësimore. (Përkatësisht: LAB 1: Përmban 21 kompjutera + 1 video projektor, LAB 2: Përmban 21 kompjutera + 1 video projektor, LAB 3: Përmban 29 kompjutera + 1 video projektor. LAB 4: Përmban 29 kompjutera + 1 video projector). Në njërin prej laboratorëve ishte i instaluar programi financiar Financa 5 versioni demo i cili ishte përdorur vetëm për një kohë të shkurtër me studentët e programit të studimit. Studentët konfirmuan se kanë akses në laboratorë në çdo moment, gjatë gjithë javës dhe edhe në fundjavë nëse dikush ka nevojë të punojë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Sipas raportimit në RVB, konstatohet se Institucioni kujdeset të hartojë udhëzues për të garantuar cilësi dhe inovacion në mësimdhënie (Libri i Rregulloreve Institucionale, Manualët, Guida e Studentit (Student Guide); Manuali i Stafit (Staff Handbook), etj. Konstatuar gjatë vizitës në Institucion, metodat e mësimdhënies së pedagogëve të Institucionit ishin të vlerësuara nga studentët të cilët u shprehën pozitivë për njohuritë e përfutuara gjatë orëve të mësimt.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Duke shqyrtuar dosjen e dokumentacionit GVJ konstaton se janë dy elemente që përdoren nga Institucioni për të kontrolluar aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik: 1) Sipas rregullores “Mbi procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e programeve të studimit”, është NjSBC që në bashkëpunim me njësitë kryesore dhe ato bazë, kanë përgjegjësinë kryesore për mbarëvajtjen dhe rritjen e cilësisë në institucion. Cilësia sigurohet nëpërmjet vlerësimit të performancës së stafit, plotësimit të formularëve të vetë-vlerësimit si edhe nëpërmjet monitorimit të programeve. 2) Vlerësimi i procesit të mësimdhënies bëhet në mënyrë të rregullt nëpërmjet pyetësorëve drejtuar studentëve para zhvillimit të provimit përfundimtar. Sic edhe u konfirmua gjatë vizitës në Institucion, rezultatet e vlerësimit diskutoheshin me anëtarët e stafit akademik me qëllim përmirësimin e performancës së tyre.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>GVJ konstatoi se studentët janë të përfshirë në plotësimin e anketimit për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies. Në mënyrë konsistente NjSBC bashkë me fakultetet dhe departamentet organizojnë “Pyetësorët e studentëve” për secilin program dhe lëndë; marrjen e informacionit, përmes pyetësorëve mbi ecurinë e institucionit.</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u njoh edhe me rezultatet e anketimeve më të fundit të cilat nuk ishin përfshirë në RVB për shkak të kohës së dorëzimit të raportit. Cfarë u konstatua nga GVJ është se studentët ishin konfidentë se rastet e ankimimeve nga ana e tyre, pavarësisht se ato (ankimimet) kishin qenë minimale, ishin mirëpritur dhe zgjidhur shpejt nga ana e Institucionit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Bazuar në të dhënat e marra gjatë vizitës në Institucion, GVJ referon se informacioni i mbledhur nga vlerësimi i cilësisë përfshihet në vlerësimin institucional, ose atë të NjSBC. Kështu, Raporti i Vlerësimit të Programit të Studimit në përfundim të vitit akademik 2018-2019 përmban të dhëna në lidhje me vlerësimin e cilësisë. Gjithashtu, u konfirmua se praktikë e Institucionit është që rezultatet e pyetësorëve të vlerësimit institucional të publikohen në faqen e internetit të institucionit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>GVJ konstaton se Institucioni në RVB nuk referon mekanizma të vlerësimit dhe promovimit konkret të praktikave të mira. Gjatë vizitës në Institucion u konfirmua që praktikave të mira përgëzohen dhe nxiten por nuk ka stimuj financiarë.</p> <p>Cfarë referohet është organizimi i trajnimeve të stafit akademik të IKT në fushën e cilësisë së edukimit, ku trajnime të ndryshme mbi këtë fushë janë kryer prej NjSBC dhe Rektorati; e megjithatë këto trajnime mbeten minimale. Vlerësimi i lartë pozitiv për stafin akademik nuk sjell trajtim të</p>

	diferencuar financiar por vetëm vlerësim akademik simbolik dhe kjo mund të jetë një element rishikimi për përmirësim nga ana e Institucionit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Nga shqyrtimi i tërësisë së dokumentacionit të dorëzuar nga ana e KU CIT, GVJ konstatoi se si rregull i përgjithshëm Institucioni aplikon si forma mësimdhënie leksionet, seminarët, detyrat e kursit, esetë, projektet, praktikat profesionale dhe me raste edhe orët e hapura me lektorë të ftuar. Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të Programit të Studimit, si edhe e dosjes së syllabuseve, por edhe nga konfirmimet gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se format e mësimdhënies për këtë program specifik janë leksionet, seminarët, detyrat e kursit/esetë, praktikat profesionale (jo vetëm në 4 javët e parashikuara gjatë semestrit të fundit të studimeve, por edhe internshipe gjatë studimeve), si edhe orët e hapura me lektorë të ftuar të fushës së kontabilitetit dhe financës dhe vizitat në institucione me rëndësi në fushën e Financë Kontabilitetit - ALSE (Albanian Stock Exchange), dhe KKK – Keshilli Kombëtar i Kontabilitetit).
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.	Gjatë vizitës së GVJ në Institucion dhe bisedave me stafin, personeli akademik i KU CIT u shpreh i motivuar nga niveli i lartë i studentëve të programit të studimit Bachelor në Financë dhe Kontabilitet dhe ishin të nxitur që të mirëprisnin larminë e kërkesave apo të sugjerimeve të studentëve. Pedagogët u shprehën se përveç metodave klasike të mësimdhënies, si shpjegimi i leksionit, ata nxisnin edhe metoda interaktive të mësimnxënies si: referimet me gojë të studentëve, të cilat në disa prej lëndëve të programit të studimit kishin edhe një peshë të konsiderueshme në vlerësim, detyra të shkurtra me shkrim (ese), projekte studimi në grup për të nxitur bashkëpunimin mes palëve në kushte simuluese të punës, lektorë të ftuar nga fusha e financë – kontabilitet, ndër ta edhe lektorë të huaj, vizita në institucione me rëndësi si ALSE (Albanian Stock Exchange), dhe praktikën e mentorimit të studentëve për studentët e viteve më të ulëta.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	Gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se KU CIT mbështet personelin e tij akademik për përmirësimin e kompetencave didaktike duke i nxitur dhe mbështetur të botojnë rezultatet e kërkimeve të tyre edhe në botimin kërkimor që vetë Institucioni publikon dy herë në vit CIT Review Journal (botimi i fundit është i marsit 2019). Gjithashtu shumë prej stafit të Institucionit kanë studiuar dhe punuar në universitete të njohura cka zgjeron dhe forcon eksperiencën e tyre.

<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ ndeshi një ndër dokumentet e hartuara nga institucioni: “Mbi strategjitë e mësimdhënies në KU IKT” i cili është bazë për përmirësimin e procesit të mësimdhënies. Sipas këtij dokumenti, dhe konfirmuar edhe nga studentët e programit të studimit, pedagogët kanë prezantuar dhe përdorur një larmi metodash dhe burimesh të mësimdhënies, brenda dhe jashtë klasës, për të motivuar, sfiduar dhe përfshirë studentët, duke përfshirë: Të mësuarit eksperimentues; Teknika inteligjente të pyetjeve; Aktivitete praktike; Folës / ekspertë të ftuar në klasë; Puna në grup e bazuar në studimin e rasteve; Detyrat e bazuara në hulumtime.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Librit të Rregulloreve Institucionale, GVJ konstaton se studentëve u kërkohet të ndër marrin një rol aktiv në procesin e mësimit jo vetëm duke u angazhuar në mënyrë interaktive por duke marrë pjesë edhe në vlerësimin e metodave të mësimdhënies (Libri i Rregulloreve Institucionale, Kapitulli III, kreu III, “Strategjitë e Mësimdhënies në IKT” (Teaching strategies in CIT), fq. 44-52. Gjatë intervistave, personeli akademik u shprehën të hapur për të reflektuar vërejtje të studentëve përsa i përket qasjeve akademike të tyre. Pavarësisht se nuk kishte pasur shumë vërejtje të tilla madhore në të shkuarën, stafi u shprehën që mirëprisnin kërkesat e studentëve. Edhe këta të fundit u shprehën se stafi akademik ishte fleksibël kundrejt kërkesave të paraqitura prej tyre.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Bazuar në pyetje drejtuar studentëve të programit të studimit dhe stafit akademik përkatës GVJ konstaton se pedagogët janë të interesuar të ofrojnë një larmi metodash interaktive si: Sesione interaktive seminare dhe tutoriale; Përdorimi i metodave / burimeve të tjera interaktive si paraqitje e videove mësimore; Shpjegime të detajuara; Përdorimi i metodave virtuale të mësimdhënies (cka morën një rëndësi të papritur në situatën e sapokaluar në pranverën e vitit 2020); Udhëtime dhe vizita në terren. Orët mësimore vlerësohen të jenë interesante dhe përdorimi i metodës së vlerësimit të vazhdueshëm gjykohej pozitiv nga studentët pasi i mbante të angazhuar përgjatë gjithë semestrit.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënive të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Bazuar në pyetje drejtuar studentëve të programit të studimit GVJ konstaton se format e mësimdhënies të zbatuara nga pedagogët e KU CIT i nxisin studentët të marrin pjesë aktive dhe të reflektojnë në mësimdhënie, si edhe të përpiqen të formojnë opinione dhe mendime të pavarura në lidhje me situata të ndryshme (Libri i Rregulloreve Institucionale, Kapitulli III, kreu III, “Strategjitë e Mësimdhënies në IKT” (Teaching strategies in CIT), fq. 44-52. Gjithashtu, çfarë GVJ konstatoi gjatë vizitës në Institucion, ishte një marrëdhënie e hapur mes studentëve dhe pedagogëve. Studentët ndjeheshin të lirshëm të kërkonin asistencën e pedagogëve jo vetëm gjatë orareve të përjavshme të konsultimeve me ta, por edhe në orare të tjera sporadike sipas nevojave të studentëve.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<b>X</b>



**Standardi III.3**

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Pas verifikimit të dokumentacionit dhe vizitës në Institucion GVJ konstaton se KU CIT ofron mjedise me infrastrukturën e nevojshme, (ndricim, sistem kondicionimi, ujë, wireless, bibliotekë për të lexuar apo studiuar, dhe laboratorë) për të realizuar procesin mësimor. (“Raporti i verifikimit të infrastrukturës së KU “IKT”). KU CIT kryen edhe dezinfektimin e institucionit. (Fatura dhe Certifikata e Shërbimit të Dezinfektimit, dok. nr. 92 në DVV).</p> <p>GVJ gjatë vizitës konstatoi se ambientet ishin të përshtatshme për mësimin. Vetë studentët vlerësuan maksimalisht vendndodhjen e Institucionit, por u shprehën që do të kishin vlerësuar nëse do të ishte një kampus tradicional (me ambiente outdoors). Në këtë kontekst, Institucioni ka planin e ndërtimit të kampusit në të ardhmen.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Gjatë vizitës, GVJ konstaton se në KU CIT klasat janë të pajisura me mjetet e nevojshme për të bërë funksional procesin mësimor, si kompjuterat, projektorë, tabela shënimesh, etj. Për takime të mëdha shfrytëzohet salla e konferencave. Institucioni disponon 4 laboratorë kompjuterikë të pajisur me mjetet e nevojshme për zhvillimin e orëve laboratorike.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>GVJ konfirmoi se në ambientet e Institucionit funksionon rrjeti wireless ku ka akses cdo student, dhe qasje në sistemin e informacionit në ambientet e Universitetit por edhe jashtë tij. Në RVB, raportohet se kompjuterat në laboratorë dhe ato në cdo sallë mësimi janë të pajisur me softuerët e nevojshëm, për të cilët Institucioni ka blerë licencat. Instalimi, mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i Departamentit të IT në kohë reale në bazë të kërkesave të pedagogëve. Për realizimin e procesit mësimor në funksion të programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet, KU CIT ka pasur të instaluar më parë në një nga laboratorët programin financiar Financa 5, version demo, i cili kishte vetëm akses të përkohshëm, aktualisht jo funksional.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve, GVJ konstaton se ofrohen tituj të mjaftueshëm në literaturën bazë dhe ndihmëse të vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën angleze që është edhe gjuha e programit të studimit, cka mundëson marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit. Gjithashtu, sic u verifikua nga diskutimet me pedagogët, u konstatua se për disa lëndë specifike ku janë të rëndësishme karakteristika të vecanta të realitetit shqiptar, pedagogët përpiqeshin t’u jepnin studentëve edhe materiale nga vendi (si raste studimore të shoqërive ekonomike shqiptare; pjesë nga legjislacioni i vendit tonë; vecori të kontabilitetit në Shqipëri, etj), por që gjykohen se mund të pasurohen në të ardhmen.</p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se biblioteka e KU CIT ka hapësira të përshtatshme për përdorim nga studentët. Biblioteka disponon 6 kompjutera të cilat janë në dispozicion të studentëve, dhe janë pjesë e integruar e Bibliotekës për të aksesuar librat dhe burimet elektronike të disponueshme në bibliotekë. Materialet e bibliotekës mund të përdoren ose në mjedisin e bibliotekës, ose mund të huazohen për përdorim të jashtëm. Biblioteka paraqitet e pasur në tituj virtualë si edhe në aksesin në tekste akademike dhe botime periodike të fushës. (Dok. nr.56 Dokumentacioni mbi Biblioteken e KU IKT).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit verifikohet se KU CIT ka marrëveshje bashkëpunimi me shtëpinë botuese McGrawHill Education që në funksion të procesit mësimor u jep mundësinë si stafit edhe studentëve të aksesojnë burimet online të ofruara. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, stafi dhe studentët u shprehën për shkallën e lartë të përdorimit të këtij mjeti dhe për dobishmërinë e tij. Shfrytëzimi i titujve anglisht nga kjo shtëpi botuese është edhe një ndër avantazhet e këtij programi studimi.</p> <p>Në mënyrë më sporadike, në varësi edhe të natyrës së lëndëve të caktuara, GVJ konstatoi se nga disa prej pedagogëve përdorin edhe burime të tjera (nga RVB: Consortium for Open Education Resources - BCcampus – OpenEd - Open Textbook Catalog - The Free Library - Open Textbook Catalog - BCcampus – OpenEd - Full-Text Books Google - Free Archive.org) kryesisht për artikuj kërkimorë, detyra dhe projekte kursi apo lexime suplementare.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të syllabuseve, GVJ konstatoi se shumë prej tyre kërkonin përgatitjen e detyrave dhe projekteve të kursit. Laboratorët e Institucionit u verifikua se janë funksionalë dhe ofrojnë mundësi që studentët të përgatisin diplomat, detyrat dhe kërkesat e tjera të programit mësimor. Orari i shfrytëzimit të laboratorëve ishte gjatë gjithë javës përfshi edhe ditën e shtunë. Vetë studentët u shprehën se shfrytëzojnë maksimalisht laboratorët si edhe facilitetet infrastrukturorë për printimin e materialeve të cilat u janë lënë në përdorim të lirë pa limit.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Bazuar në shqyrtimin e DVV, (dokumenti 70 nëDVV), GVJ konstaton se KU CIT përdor University Management System, CIT E-Learning sisistem përmesaxhimin e procesit mësimor dhe për materialet e hedhura në këtë platformë nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive etj. Gjatë vizitës në Institucion u mësua se CIT E-Learning është një sistem pronësor i brendshëm dhe specifik i zhvilluar nga vetë Institucioni dhe gjykohej praktik dhe i dobishëm si për personelin akademik ashtu edhe nga studentët.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Nga intervistat e zhvilluara me studentët u mësua se sistemet e komunikimit të brendshëm dhe aksesin në dokumentacionin elektronik përdorej në mënyrë të konsiderueshme nga ata. Secilit prej tyre i jepej aksesin në dhjetë tekste akademike mësimore të platformës McGrawHill gjatë një viti dhe kështu ata kishin mundësi të shkarkonin në hapësirën vetjake të sistemit materialet e nevojshme për procesin mësimor.</p>

<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Në bazë të Rregullores së Programit të Studimit, studentët orientohen nga pedagogë udhëheqës që u caktohen qysh në fillim të procesit.</p> <p>Pedagogu e ndihmon studentin në çdo fazë të këtij punimi, lidhur me marrjen, analizën e të dhënave, nxjerrjen e konkluzioneve dhe ofrimin e rekomandimeve përfundimtare të punimit. Ky proces kryhet për herë të parë në KU CIT dhe sipas verifikimit me studentët kishte filluar në muajt janar shkurt të vitit 2020 me caktimin e pedagogut mbikëqyrës, caktimin e temës së diplomës dhe ndjekjen e hapave të mëtejshëm. Aktualisht të gjithë studentët e vitit të tretë ishin duke punuar për temat përkatëse të diplomave.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV, GVJ konstaton ngritjen e një strukture për promovimin e përmirësimit të vazhdueshëm dhe garantimin e cilësisë. Kjo njësi njihet si NJSBC (Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë) dhe në KU CIT është themeluar në vitin 2013. Kjo njësi është themeluar në nivel institucioni dhe ka përfaqësues të të dy njësive kryesore të KU CIT. NJSBC ka pesë anëtarë nga të cilët një është përfaqësues i Këshillit Studentor. Mandati i anëtarëve të NJSBC është 4 vjet.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>GVJ, referuar DVV, dhe më konkretisht referuar Rregullores së Departamentit të Administrimit Biznesit, konstaton se ky departament është njësi bazë përgjegjëse për programet e studimit që ofron, që nga përzgjedhja e personelit akademik që angazhohet në mësimdhënien e deri tek shpërndarja optimale e ngarkesës mësimore. Nga vizita në Institucion, GVJ-së iu konfirmua se është Përgjegjësi i departamentit ai që së bashku me Dekanin miraton syllabuset e hartuara dhe bën vlerësimin e mësimdhënies. Stafit i departamentit dhe studentët janë në dijeni qysh në fillim të vitit akademik që do i nënshtrohen një procesi të vlerësimit të procesit mësimor.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Në RVB, Institucioni KU CIT shprehet se është i angazhuar për të nxitur kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij. Institucioni mbështet zhvillimin e konferencave dhe pjesëmarrjen e stafit në të, mobilitetin e stafit me qëllim zgjerimin e eksperiencës dhe zhvillimin e stafit. Eksperimentimi i metodave të reja inovatore të mësimdhënies u inkurajua në mënyrë të vecantë gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2019-2020 nisur edhe nga situata e vecantë e paraqitur.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit</p>	<p>Nga shqyrtimi i materialeve të dorëzuara si pjesë e DVV, konstatohet nga ana e GVJ se raportohet që personeli akademik kualifikohet në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor. Pjesëmarrja në konferenca</p>

shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	ndërkombëtare, në projekte si dhe botime shkencore të stafit gjenden në tërësinë e dokumentacionit të dorëzuar. Megjithatë, personeli akademik i pyetur nuk konfirmoi mbështetjen financiare në fushën e kërkimit shkencor në të shkuarën, por u shprehën pozitivisht për të ardhmen mbështetur në ndarjen e buxhetit të institucionit sipas njësive kryesore.			
<b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Certifikatat e trajnimeve të stafit nga IKT të cilat janë pjesë e DVV tregojnë se Institucioni ka bërë përpjekje për trajnimin e vazhdueshëm të personelit akademik, sidomos në bashkëpunim me partnerët e huaj me të cilët ka marrëveshje (programet Erasmus +, Mevlana, CEEPUS).  Cfarë u konstatua nga GVJ gjatë vizitës në Institucion është se deri më tani, personeli akademik i këtij programi specifik studimi nuk ka përfituar trajnime nga mobilitetet e sipërpërmendura.			
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Nga informacionet e marra gjatë diskutimeve me personelin akademik të programit mësimor në vizitën në Institucion, GVJ formoi bindjen se personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik që janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit angazhohet maksimalisht për përmirësimin e metodikave të mësimdhënies dhe janë të interesuar dhe të hapur për implementimin e metodave të reja të mësimdhënies.			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Sipas diskutimeve me anëtarë të personelit akademik gjatë vizitës në Institucion, personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik nxiten të testojnë metoda të reja në mësimdhënie dhe të analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për to. Çdo vit, gjatë rishikimit të syllabuseve ekziston mundësia për implementimin e metodave të reja të mësimdhënies dhe kjo u konfirmua nga vetë pedagogët e lëndës para GVJ.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstatoi se kriteret dhe mënyra e testimit dhe e vlerësimit të njohurive të studentëve përcaktohen në Rregulloren e Programit të Studimit dhe në Rregulloren “Mbi Vlerësimin e Studentit”, që gjendet në Librin e Rregulloreve Institucionale. Këto rregullore bëhen publike dhe sic u verifikua edhe nga GVJ gjatë vizitës në Institucion, studentët njihen me këto mënyra edhe për shkak të faktit se përfshihen në syllabuse të lëndëve mësimore dhe diskutohen në javën e parë të cdo semestri.
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive	Bazuar në informacionet e marra gjatë vizitës në Institucion dhe kryesisht nga diskutimet me studentët e programit të studimit GVJ konstatoi se ata njihen në fillim të çdo lëndë/moduli me metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të

profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. Mënyra e vlerësimit përfshihet edhe në Guidën e Studentit (dok.nr.29 nëDVV).			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	GVJ pasi shqyrtoi syllabuset e lëndëve vërejtë se në to, ka elemente të larmishme të kontrollit dhe vlerësimit të njohurive si: provimet dhe testimet, detyrat e kursit dhe niveli i aktivizimit në seminare apo punë laboratorike, provimet e ndërmjetme, vlerësimet mbi bazën e përgjigjeve të sakta, etj. GVJ gjykon se përfshirja e një larmie të formave të vlerësimit u jep mundësinë të gjithë studentëve të shprehin format e vecanta të aftësive dhe talenteve të tyre dhe të mbrojnë kompetencat e fituara gjatë zhvillimit të procesit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	<p>Bazuar në analizën e detajuar të syllabuseve të lëndëve në KU CIT, GVJ ka konstatuar se vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm gjatëgjithëperiudhës mësimore dhe vitit akademik. Sipas dokumentit “Vlerësimi i Studentit” (Student Evaluation - Libri i rregulloreve Institucionale, “Mbi vlerësimin e studentit” (Student Evaluation), fq. 55),KU CIT ka një formë të përgjithshme të vlerësimit të studentëve si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive 10%</li> <li>- Plotësimi i detyrimeve (kuizeve, studimeve të rastit, detyrave/projekteve të kursit) 40%</li> <li>- Provimi i Ndërmjetëm 20%</li> <li>- Provimi përfundimtar 30%</li> </ul> <p>por megjithatëshprehet se lejon njëluhatje deri 20% për cdo element duke respektuar vecantitë e lëndëve mësimore të ndryshme. GVJ gjykon se shpërndarja e vlerësimit të njohurive dhe dijeve përgjatë vitit / semestrit si edhe larmia e formave të vlerësimit (detyra me shkrim, provime, prezantime) mënjanon fiktivitetin në vlerësim duke ulur varësinë nga një formë e vetme vlerësimi; nxit studentët të përgatiten sistematikisht dhe në përgjithësi përmirëson performancën e studentit.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Në RVB raportohet se Institucioni nuk përdor metoda apo sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit pasi vlerëson se, përveç pjesëve (pyetjeve) të testimit që përmbajnë alternativa, studentët duhet të jenë të aftë të analizojnë dhe t’u përgjigjen një pjese të pyetjeve, brenda vlerësimit, me shkrim dhe në mënyrë subjektive të zgjeruar. I njëjti fakt u konfirmua edhe gjatë vizitës në Institucion, duke u shoqëruar edhe me argumentin e

	numrave të ulët të studentëve që nuk justifikojnë dhe as bëjnë të nevojshëm përdorimin e sistemeve elektronike të vlerësimit.
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Në RVB të Institucionit deklarohet se provimet realizohen nga titullarët e lëndëve/moduleve ose edhe të ndihmuar nga një asistent lektor (co-teacher) nëse lënda/moduli ofrohet prej 2 pedagogëve. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, ky fakt u pohua nga ana e pedagogëve të Departamentit të Administrim Biznesit i cili është njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit. Pra, kryesisht komisionet e provimeve ishin me një anëtar duke bërë që ky kriter të mos përmbushet plotësisht.
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Në bazë të dokumentit Guida e Studentit (fq. 25-26, 28-30), vlerësimi i testimeve më shkrim në KU CIT bëhet në mënyrë anonime ku të gjitha testet/tezat e provimit janë të sekretuara. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, kjo procedurë konfirmohet nga studentët dhe pedagogët e programit të studimit.
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Në RVB të programit të studimit citohet se vlerësimi i njohurive në provime dhe teste, është i shoqëruar me komentet përkatëse të vlerësimit në mënyrë që studenti të jetë sa më i qartë dhe i vetëdijshëm për gabimet a pasaktësitë e tij. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, kjo procedurë konfirmohet nga studentët të cilët u shprehën se në cdo rast, vlerësimet e provimeve të tyre ishin të argumentuara nga ana e pedagogëve.
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	Në RVB citohet se gjatë provimeve ndalohet përdorimi i aparatëve celularë dhe mjeteve të tjera elektronike. Nga ana tjetër, nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndës dhe i dokumenteve të tjera të dorëzuara, GVJ konstaton se Institucioni i mëshon rëndësi të konsiderueshme çështjeve etike dhe të plagjiaturës dhe parashikon masa disiplinore në situata të tilla. Të pyetur për reagimin dhe masat e marra në situata të tilla, konkrete pedagogët nuk ngurruan të argumentojnë përse e konsiderojnë të rëndësishëm kultivimin e kulturës antiplagjiaturë duke u treguar kategorikë për të refuzuar pajtimin me këto praktika në rast konstatimi të tyre.
<b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Nga shqyrtimi i Rregulloreve të Institucionit dhe konfirmuar gjatë vizitës në Institucion, procedura e publikimit të rezultateve të kontrollit parashikon afate të cilat në përgjithësi ndiqen nga ana e Departamentit. Për të garantuar vlerësimin në bazë të meritës, parashikohet edhe afati i kërkesave për rishikime të vlerësimit. Siç përshkruhet edhe në Udhëzuesin Studentor (Student Guide), ankesat ose ankimimet kundër vendimeve akademike u përkasin të drejtave të studentit.
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	GVJ konstaton se dokumentet: Guida e Studentit, fq. 10-12 si edhe Rregulloret e Sekretarisë Mësimore për Ciklin e Parë, 2019-2020, fq. 6-7 parashikon hapat e procedurës së ankimit nga ana e studentëve.  Ankesat në lidhje me rezultatet e provimit përfundimtar merren parasysh vetëm nëse ato janë paraqitur brenda katërmbëdhjetë ditësh nga shpallja e notës. Studentët u shprehën se e kanë shfrytëzuar të drejtën e rishikimit të vlerësimit dhe kanë gjetur përkrahjen e pedagogëve për të ushtruar këtë të drejtë të tyre.

<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Sipas dokumentit “Rregullore e Sekretarisë Mësimore për Ciklin e Parë” (dok.nr.22 në DVV), zgjidhja zyrtare e ankesave bëhet duke ndjekur një procedurë e cila parashikon edhe ngritjen e një komiteti ad hoc nga ana e Presidentit. Zëvendës-rektori ose komiteti ad hoc i jep mundësinë studentit të dëgjohet, nëse dëshiron ashtu. Seanca dëgjimore të bëhet brenda 15 ditësh nga pritja e njohjes. Vendimi i njoftuar nga zëvendës-rektori është përfundimtar. Pyetjet gjatë vizitës në Institucion konfirmojnë procedurën.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
<p><b>X</b></p>				

<p><b>Standardi III.7</b>  <b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Sic është delaruar nga ana e Institucionit qëllimi i këtij programi studimi është “formimi, përditësimi, aplikimi i njohurive praktike, analitike profesionale apo kërkimore, si edhe zhvillimi i aftësive të nevojshme tek të sapodiplomuarit që ata të integrohen më së miri në tregun e punës në disiplinën e Financës dhe Kontabilitetit”. GVJ konstaton se ky qëllim përmbushet kryesisht nga organizimi dhe përmbajtja e lëndëve të programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor dhe i syllabuseve të Programit të Studimit, GVJ konstaton se ky program mundëson thellimin e njohurive në mënyrë të përgjithshme në fushën e teknologjisë së informacionit (njohuri mbi disa programe kompjuterike bazë në lëndën Bazat e Shkencës Kompjuterike) si edhe në aspektet e komunikimit dhe ndërveprimit (Academic Reading and Writing I and II por edhe lëndëme zgjedhje të etikës në biznes, gjuhë e huaj e cila është baza e programit, Business Communication and Negotiation, etj). Më shumë mund të bëhet në drejtim të programeve të vecanta kompjuterike në fushën e kontabilitetit, apo edhe të etikës, e cila nga një lëndë me zgjedhje që është aktualisht, mund të konsiderohet për të kaluar si lëndë bazë e detyrueshme duke zëvendësuar ndoshta lëndën Metodat e Kërkimit në Financë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>GVJ konstatoi se syllabuset e lëndëve përfshijnë të gjitha një element të rëndësishëm i cili është “Student Learning Outcomes” (Rezultatet e të nxënit nga studentët) dhe që tregon përfitimet nga cdo lëndë. Shumë prej syllabuseve gjithashtu konstatohet se kanë edhe seksionin e “Graduate Attributes” që përshkruan atributet e të diplomuarit dhe aftësitë që ai duhet të ketë në tregun e punës. Si GVJ gjykojmë se përfshirja e këtyre dy elementeve në syllabus, orienton drejtimin dhe zhvillimin e lëndëve.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe</p>	<p>Në RVB të Programit të studimit deklarohet se: në javën e fundit të programit të lëndës pedagogu bën një përsëritje njohurish dhe konceptesh më thelbësore, e cila orienton studentët mbi strukturën e provimit përfundimtar, si një nga elementët e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të</p>

orienton studentët për implementimin e tyre.	fituara nga ana e studentit gjatë zhvillimit të lëndës/modulit, duke vënë theksin në analizën dhe të kuptuarit e kompetencave të fituara nga lënda/moduli. GVJ gjatë vizitës në Institucion, konfirmon këtë praktikë e cila u konsiderua orientuese dhe vlerështuese nga ana e studentëve.
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Institucioni KU CIT raporton se shpesh orët mësimore zhvillohen jo vetëm në auditor, por në bashkëpunim me industrinë, bizneset dhe sipërmarrjet, në të cilat kanë marrë pjesë specialistë, emra të njohur të fushës, si dhe të ftuar të ndryshëm, që kanë ndarë eksperiencën e tyre me studentët. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton vlerën e këtyre ngjarjeve për studentët e këtij programi studimi specifik. Eventet e lektorëve të jashtëm të ftuar, por edhe vizitat në Institucione u vlerësuan me interes për formimin e studentëve dhe madje ata kishin kërkuar sa më shumë organizime të kësaj natyre.
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikatat profesionale.	Gjatë vizitës në Institucion GVJ pati mundësinë të konfirmojë kryerjen e praktikave mësimore si edhe zbatimin e njohurive të përfutuara nga studentët në laboratorë. Nxjerrim edhe njëherë në pah mungesën në planin mësimor të lëndëve specifike të dedikuara për teknologjinë e informacionit për financën dhe kontabilitetin. Nevoja për njohuri në këtë fushë bëri që Institucioni të ofrojë (jo që në vitin e parë, por më pas) disa leksione si pjesë e një prej lëndëve ekzistuese të Planit Mësimor.
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Bazuar në analizën e kryer mbi syllabuset e Programit të Studimit, del në pah se preferohet puna në ekip e studentëve, si mënyrë inkurajimi e zgjidhjeve inovatore të problematikave të caktuara. Nga vizita në Institucion, një praktikë e tillë u konfirmua edhe nga studentët të cilët u shprehën se kjo i kishte aftësuar të ishin më interaktiv në klasë dhe jashtë saj.
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Nga intervistat me personelin akademik të Programit të Studimit GVJ konstaton se ata janë të gatshëm të krijojnë klimë inkurajuese në favor të ideve inovatore dhe studimeve të avancuara nga ana e studentëve. Vetë studentët u shprehën se ata inkurajohen vazhdimisht të eksplorojnë tema të ndryshme kërkimore aktuale, nëpërmjet ofrimit të logjistikës laboratorike, apo mbështetjes për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme.
<b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Në RVB, Institucioni deklaroi se në mbështetje të studentëve ka qenë suportimi financiar për organizimin e konferencave studentore, akademike verore, start up-eve si dhe iniciativave të prezantuara prej tyre. Gjatë intervistave me studentët, GVJ konstaton se specifikisht për programin e studimit Bachelor në Financë Kontabilitet pjesëmarrja në akademi verore dhe start-up ka qenë më e reduktuar sesa për programet e tjera.
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Nga shqyrtimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit si edhe dosjes së eventeve të organizuara vihet re se Institucioni ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh në fushën e kërkimit shkencor, shkëmbim të stafit akademik dhe të studentëve, megjithatë, këto marrëveshje nuk kanë qenë specifikisht të lidhura me këtë program studimi. Gjatë vizitës në Institucion u kërkua informacion specifik për marrëveshjet e bashkëpunimit për këtë program studimi si edhe për projektet e fituara për këtë program. Informacioni u vendos në dispozicion nga ana e Institucionit konform afateve dhe rregullave.



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në DVV, GVJ konstaton se për mbarëvajtjen e procesit të përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës Institucionika hartuar disa rregullore të cilat i listojmë në vijim: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Rregullorja “Mbi shkrimin e tezës së diplomës”, që gjendet në Librin e Rregulloreve Institucionale, fq. 62-73.</li> <li>2. Rregullorja e Sekretarisë Mësimore për Ciklin e Parë të Studimeve, fq. 7-8.</li> <li>3. Rregullorja e Programit të Studimit, fq. 9. 4. Manuali i Punimit të Temës së Diplomës.</li> </ol>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Diplomimi në KU CIT bëhet me përgatitjen dhe mbrojtjen e një punimi diplome për një temë të caktuar studimi dhe/ose kërkimi.  GVJ konstaton se për vitin akademik 2019 – 2020 që është edhe gjenerata e parë të diplomuarve në këtë program studimi, për cdo student janë përcaktuar pedagogët udhëheqës dhe në kohën e vizitës në Institucion (qershor 2020) kishte filluar puna për përgatitjen e temave të diplomave.
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	<b>N/A Institucioni nuk aplikon provimin final por mbrojtjen e temave të diplomave.</b>
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Sipas RVB, cdo anëtar i stafit akademik, brenda javës së tretë të semestrit të parë, ofron propozime konkrete për temat e diplomimit, të cilat ai / ajo është i gatshëm të mbikëqyrë, duke bërë të mundur krijimin e një liste referenciale me tema diplomash të sugjeruara për t’u punuar.  Në fillim të vitit akademik, Departamenti i Administrim Biznesit organizon një takim për të konsultuar tema të ndryshme që mund të shërbejnë si referim për studentët që do të diplomohen në semestrin e dytë të vitit të tretë.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Sic GVJ është shprehur edhe më lart në këtë raport, viti akademik 2019-2020 është viti i parë për studentët që do të diplomohen në Programin e Studimit Bachelor në Financë Kontabilitet. Nga pyetje konkrete që iu drejtuan studentëve që po përgatisin punimet e diplomës, GVJ u informua se në këtë proces, Institucioni kishte vendosur në dispozicion, jo vetëm lehtësira infrastrukturore, por edhe aksesin në bibliotekë online.

<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Sipas verifikimeve nga ana e GVJ gjatë vizitës në Institucion, udhëheqësi i diplomës asiston studentin në cdo fazë të punimit të temës së diplomës duke nisur nga nxjerrja e rezultateve, përpunimi i tyre, si dhe shkrimi i temës sipas udhëzuesve të miratuar (ka disa dokumente të cilat orientojnë studentët për këtë proces, shiko kriteri 1 më lart). Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. Pa miratimin e udhëheqësit të diplomës, studentët nuk mund të dorëzojnë punimet e tyre.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>GVJ gjatë punës së tij shqyrtoi dokumentin “Manuali i Punimit të Temës së Diplomës” në të cilin specifikohet se Tema e diplomës, në bazë të udhëzimeve të ministrisë së linjës dhe bazuar dhe në planin mësimor është 6 ECTS dhe vlerësohet me notë.</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Sipas dokumentacionit, me marrjen e vlerësimit të punimit studentët e programit të studimit fitojnë të drejtën e marrjes së diplomës Bachelor në “Financë dhe Kontabilitet” dhe pajisen përveçse me diplomën, edhe me suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Kjo procedure është në zhvillim e sipër dhe pritet të përfundojë në të ardhmen me diplomimin e brezit të parë të studentëve në këtë program studimi.</p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në dokumentacionin e dorëzuar nga Institucioni specifikohet se në përfundim të studimeve, studenti pajiset, përveç diplomës edhe me suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Bashkë me këtë i jepet edhe një kopje e programit si dhe një listë notash. Kjo procedure është gjithashtu në zhvillim e sipër dhe pritet të përfundojë në të ardhmen me diplomimin e brezit të parë të studentëve në këtë program studimi.</p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Financë – Kontabilitet diplomon student për herë të parë për këtë vit akademik (2019-2020). Gjatë vizitës në Institucion, GVJ konfirmoi me zgjedhje dosjet e dy studentëve dhe konfirmon se Institucioni ka ruajtur kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,  
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi IV.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësitor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Përgjegjëse për ruajtjen e të dhënave të personelit akademik, ndihmës mësitor dhe administrativ të angazhuar në programin e studimit është Zyra e Burimeve Njerëzore, së bashku me Arkivin e institucionit.</p> <p>Sipas RVB, zyra e Burimeve Njerëzore e ngritur në nivel institucional disponon: të dhëna të plota dhe të hollësishme në lidhje me personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme të angazhuar në programin e studimit, si dhe të personelit ndihmës mësitor-shkencor dhe administrativ.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Bazuar në bazën ligjore në fuqi dhe në nenin nr.70 të rregullores së brendshme të KU “IKT”, institucioni ka hartuar politikat dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik, të cilat përfshijnë qëllimin e rekrutimit, kriteret kryesore të rekrutimit, përcaktimin e nevojave për personel të ri, procedure në aplikimit, zhvillimin e procesit të konkurrimit, vlerësimin e personelit akademik, përfshirjen e lektoreve të huaj dhe pedagogëve të ftuar etj.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Procedurat dhe kriteret për rekrutimin e personelit janë pjesë e librit të rregulloreve të miratuar nga senati akademik – Kapitulli VIII.</p> <p>Nga vizita në institucion, GVJ konstatoi zbatimin e procedurave dhe kriterëve të rekrutimit si nga njësia bazë edhe ajo kryesore. Sipas rregullores (pika VII.2 e Kapitullit VIII) dhe nga vizita në institucion, GVJ iu konfirmua se njoftimet shpallen publikisht nëpërmjet medias dhe faqes së internetit të institucionit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB dhe rregullores, Departamenti i Administrim Biznesit pas vlerësimit të nevojave për staf prezanton propozimin pranë Këshillit të Fakultetit jo më vonë se data 15 shtator, i cili ia dergon Zyres së Burimeve Njerëzore jomë vonë se data 30 shtator. Gjatë shqyrtimit të dokumenteve (dok. nr. Ref. 52.1) dhe nga takimet në institucion, u konstatua se ka një mospërputhje të vogël sepse në fakt propozimi i dergohet dekanit dhe me pas rektorit.</p> <p>Propozimi përmban lëndët që duhet të mbulohen si edhe tiullin/graden e personelit të kërkuar. Njoftimi për rekrutimin e stafit, i specifikuar me kriteret dhe afatet publikohet në faqen online të KU “IKT” dhe në media.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore bën seleksionimin paraprak të kandidatëve në bazë të vlefshëmisë së dokumenteve të aplikimit. Kandidatët që kualifikohen për fazën e mëtejshme kalojnë në intervistë. Intervista kryhet nga komisioni i rekrutimit i përbërë ngapërfaqësues të rektoratit,</p>

	<p>zyrës sëburimeve njerëzore, dhe njësisë kryesore dhe bazë. Vlerësimi bëhet me pikëindividualisht nga secili anëtar dhe vendimi i komisionit komunikohet maksimumi pas dhjetë ditësh. Vlerësimi (sipas dokumentit 52.3) bëhet në bazë të disponimit të titullit/gradës, eksperiencës në mësimdhënie, në administratë, në tregun e punës, përgjegjësitë e marra përsipër, aftësive në mësimdhënie, zotërimit të gjuhës angleze, prezantimit në intervistë etj. GVJ konstatoi se formulari i vlerësimit është standard për të gjitha pozicionet e punës: asistent/pedagog, lektor, apo profesor. Pra pavarësisht pozicionit të punës që hapet, pikët maksimale i jepen aplikantëve me më shumë artikuj, grada, tituj etj.</p> <p>Gjatë shqyrtimit të dosjes së pedagogëve, GVJ konstatoi se zyra e burimeve njerëzore nuk dispononte një dokument që tregonte pse një aplikant zgjidhej kundrejt të tjerëve. Gjithsesi, GVJ iu konfirmua se formulari i emërimit të fituesit kishte ndryshuar dhe e konstatoi edhe nga shqyrtimit të një formulari që i takonte një fakulteti tjetër (dokumenti me nr. ref. 52.4).</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	<p>KU “IKT” ka hartuar dhe miratuar rregulloren mbi shpërndarjen e ngarkesës mësimore të personelit akademik. Ajo përcakton parimet mbi bazën e të cilave bëhet shpërndarja e ngarkesës mësimore çdo vit, si p.sh një pedagog mund të ketë jo më shumë se 4 lëndë me përjashtim tëndonjëra të vecantë kur mund të marrë 5 lëndë; jo më shumë se dy kurse apo dy lëndë në semestër etj.</p> <p>Në shpërndarjen e ngarkesës merren parasysh edhe faktorë të tjerë si funksionet administrative, titulli/grada, eksperiencia apo nëse pedagogu është në proces mbrojtje doktorature, etj.</p> <p>Përgjegjësi i departamentit është përgjegjës për zbatimin e këtyre standarteve në mënyrë sa më të drejtë. Miratimi i shpërndarjes së ngarkesës mësimore bëhet nga senati në fillim të vitit akademik (dok. nr. 25).</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	<p>Nga vizita në institucion u shpreh gadishmëria e drejtuesve për tu angazhuar në kualifikimin e zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon programin e studimit.</p> <p>Konkretisht, lehtësi në ngarkesën mësimore i akordohet stafit të angazhuar në proces doktorate, duke u reduktuar ngarkesën mësimore sipas kërkesës së tyre (Vendimi i Senatit Akademik, pika 11/4).</p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Sipas RVB dhe nga vizita në institucion rezultoi se institucioni nuk organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të stafit akademik, por inkurajon personelin akademik në zhvillimin e mëtejshëm profesional të tyre.</p> <p>Sipas RVB institucioni ka organizuar disa trajnime lidhur me cilësinë e edukimit, mbrojtjen nga zjarri në vendin e punës, përdorimin e aplikacioneve software etj. Por nga një verifikim që i është bërë certifikatave të marra nga personeli akademik, ato kryesisht i takonin trainimit njëditor të mbrojtjes nga zjarri dhe nuk lidheshin drejtpërdrejt me kualifikimin e tyre profesional.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Institucioni disponon burimet e mjaftueshme njerëzore për përmbushjen e objektivave të këtij program studimi. Sipas RVB gjatë vitit akademik 2017-2018 janë angazhuar 10 pedagogë (të gjithë efektiv), gjatë vitit akademik 2018-2019 janë angazhuar 13 pedagogë (12 efektivë) dhe gjatë vitit akademik 2019-2020 janë angazhuar 15 (13 efektivë) pedagogë.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi IV.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>KU “IKT” e ushtron veprimtarinë e tij në të njëjtën godinë që në momentin e liçensimit, e cila ndodhet në Zayed Center, në Rr. “Andon Zako Çajupi”, Nr. 6. Institucioni zhvillon aktivitetin në këto mjedise prej pothuajse tetë vitesh, që prej vitit 2011. Kjo sigurohet nëpërmjet kontratës dhe shtesave që IKT ka nënshkruar me pronarët e godinës ku ndodhen këto ambiente. Shtesa e fundit e kontratës është nënshkruar për një periudhë nëntë mujore deri në shtator të vitit 2020. Gjatë vizitës në institucion, na u konfirmua shtyrje e re e kontratës. Përveç ambjenteve në këtë godinë, institucioni ka marrë me qera edhe dy ambiente të tjera që do ndihmojnë në procesin mësimor.</p> <p>Pavarësisht se në vitin 2014 është marrë vendimi për ndërtimin e një kampusi, nuk është ndërmarrë asnjë veprim në këtë drejtim. Sipas RVB institucioni ka marrë më qera ambiente me sipërfaqe totale 2297 m<sup>2</sup> për zhvillimin e veprimtarisë së mësimdhënies si dhe për zyra dhe shërbime të tjera ndëhmëse të procesit mësimor. Sipas RVB është llogaritur një sipërfaqe 8,1m<sup>2</sup> për student.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor</p>	<p>Gjate vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni disponon një numër të mjaftueshëm klasash për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve, laboratorë kompjuterikë për zhvillimin e projekteve dhe detyrave të kursit dhe zyra për stafin akademik dhe personelin ndihmës për realizimin e programit të studimit.</p>

teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Mjediset mësimore janë të pajisura me pajisjet e nevojshme teknologjike, si kompjutera, projektorë, tabela shënimesh, për zhvillimin e procesit mesimor nëpërmjet përdorimit të teknologjisë dhe metodologjisë bashkëkohore.			
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Meqënëse një nga njësitë kryesore të KU “IKT” është fakulteti i Inxhinierisë, institucioi ka në shërbim të studentëve janë 4 laboratorë informatike dhe dy laboratorë fizike, të cilët u vëzhguan edhe gjatë vizitës në institucion. Sipas RVB, të gjithë laboratorët janë të pajisur me aparaturat dhe mjetet e përshtatshme për zhvillimin sa më mirë të procesit mesimor. Instalimi, mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i departamentit të IT.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	Gjatë takimit në institucion, GVJ iu konfirmua se përveç programeve të Microsoft word dhe excel, kishte lëndë si “Financial Informatics” në të cilin ata përdornin Financën 5 – Demo. Por kur GVJ kërkoi një demonstrim të këtij programi në laborator, iu komunikua nga stafi i IT se ky program ishte hequr nga kompjuterat në laboratorë. Gjithsesi studentët konfirmuan përdorimin e këtij programi nga ana e tyre, por jo në të gjitha vitet e studimit.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Për kryerjen e praktikave mësimore, institucioni ka nënshkruar marrëveshje me disa institucione dhe biznese në vend si: Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), Shoqëria “Posta Shqiptare” sha, AMF (Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare – Ministria e Financave), ALSE, Albanian Stock Exchange (Bursa Shqipëtare e Titujve), Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, Albtelecom sh.a, Lufthansa Industry Solutions, Info Business Solution shpk, DITAK shpk, Kompania iN2, UR TSCF. IAESTE Albania. Në këtë mënyrë institucioni garanton zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Në shërbim të studentëve institucioni vë në dispozicion ambjentet e bibliotekës mësimore që ndodhet në godinën kryesore të tij, si edhe bibliotekën elektronike dhe garanton shfrytëzimin e tyre nga studentët e programit të studimit.
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e	Gjatë vizitës në bibliotekë, GVJ konstatoi se biblioteka është e pasur me tituj në fushën e financës, bankës, kontabilitetit dhe auditimit. Në bibliotekë gjenden tekste mësimorë, buletine dhe revista shkencore. Literatura është pothuajse në anglisht, meqënëse edhe gjuha e programit të studimit bachelor në “Financë dhe Kontabilitet” (por edhe e

<p>përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>programeve të tjerë të oruar nga ky institucion) është anglisht. Institucioni pasuron bibliotekën në mënyrë të vazhdueshme.</p> <p>Institucioni ofron edhe bibliotekën elektronike. Librat elektronikë që ekzistojnë në bibliotekën virtuale të IKT, janë nga bashkëpunimi me kompaninë botuese McGraw-Hill Education. Literatura e vënë në dispozicion prej marrëveshjes me McGraë-Hill Education shërben edhe për tekstet mësimore të programit të studimit bachelor në “Financë dhe Kontabilitet”.</p> <p>Sipas RVB, KU “IKT” ka bërë vazhdimisht përpjekje për të patur akses në burime të ndryshme elektronike si nëpërmjet projektit ERA 2012 ku fitoi akses në Multi-Science Journals Collection; Ebrary academic complete; EBSCO academic search premier; Emerald management eJournals Collection; ProQuest Central; Taylor &amp; Francis Library; ndërsa në vitin 2014 nënshkroi një abonim në burimet elektronike EBSCO me akses në Applied Science and Technology Source; e - Book Subscription IT core; Econlit with full tex.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Studentët kanë akses të barabartë dhe pa pagesë në titujt e bibliotekës së institucionit. GVJ iu bë me dije se për një vit, kjo bibliotekë ka qenë në shërbim falas edhe për të gjithë të interesuarit e komunitetit të zonës.</p> <p>Për sa i përket bibliotekës on-line, studentëve u jepen 10 kredite në vit, me të cilët ata kanë mundësi të aksesojnë dhjetë tituj librash në bazë të marrëveshjes me McGraw-Hill Education dhe të programit të lëndëve që do të zhvillojë gjatë vitit akademik.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës, GVJ konstatoi se biblioteka është e pajisur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për një studim komod. Gjashtë kompjutera janë në dispozicion të studentëve dhe stafit. Fondi i librave është ‘Fond i hapur’, që do të thotë se studenti ka mundësi të përzgjedhë librat vetë në rafte, të sistemuar sipas Sistemit Decimal.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Pika VI e Kapitullit VII të Librit të Rregulloreve, rregullon mënyrën e organizimit dhe funksionimit të bibliotekës. Ndër të tjerash specifikohet edhe procedura që ndiqet për shtimin e titujve në bibliotekë dhe përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit të studimit.</p> <p>Sipas RVB, biblioteka dërgon një formular dixhital "Formular për kërkesë librash" për të gjithë personelin akademik, që të propozojnë titujt që ata mendojnë të përdorin për aktivitetin e mësimdhënies, brenda një periudhe të caktuar kohe. Pas krijimit të listës së materialeve të kërkuar nga pedagogët, biblioteka fillon blerjet ndërkombëtare.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Oraret e Bibliotekës, janë përshtatur me oraret e zhvillimit të procesit mësimor. Biblioteka qëndron e hapur për studentët dhe stafin gjatë gjithë javës: E Hënë –E Premte, ora 09:00 – 13:00 dhe 14:00 – 18:00 dhe të Shtunën 11:00-15:00. Gjithsesi studentëve u mundësohet edhe marrja e librave nga biblioteka më vete për një periudhë të caktuar kohe.</p>			
	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit				X
-------------------------------------	--	--	--	---

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</b>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Proçesi mësimor në KU “Instituti Kanadez i Teknologjisë” administrohet nëpërmjet një “Sistemi Menaxhimi Institucioni” i krijuar në vitin 2016.  Sistemi është i bazuar në një platformë online, i aksesueshëm nga të gjithë studentët, stafi administrativ (sekretaritë) dhe ai akademik i KU “IKT”, nëpërmjet një Username-i dhe Fjalëkalimi të mundësuar nga departamenti i IT. Sistemi i menaxhimit është zhvilluar nga departamenti i IT së këtij institucioni.
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Gjatë takimit me Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Sekretarinë mësimore, u konfirmua se këto zyra disponojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit si të printuar, edhe në rrugë elektronike.
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	KU “IKT” siguron në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti akses të dedikuar në informacione dhe dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Platforma elektronike lehtëson komunikim interaktiv dhe mundëson shkëmbimin e informacionit midis pedagogëve, sekretarisë mësimore dhe studentëve në kohë reale.  Kur studentët regjistrohen në programin e studimit, Departamenti i IT vë në shërbim të tyre një adresë të personalizuar me emrin dhe mbiemrin e studentit, në mënyrë që ai të identifikohet në sistemin online. Studenti ka mundësi që me adresën e tij të përdorë Bibliotekën, literaturën mësimore dhe Class Roomin Virtual, të aksesojnë on-line rezultatet e provimeve, si dhe të aksesojnë pyetësorët e institucionit (të ndara nga njëra-tjetra).  Sekretaria mësimore hedhin online rezultatet e provimeve për studentët, të ndarë sipas grupeve, programeve përkatëse ku bëjnë pjesë, si dhe mundësojnë informacion të specifikuar për çdo student.  Pedagogët kanë mundësi të përdorin platformën on-line për postimin e materialeve mësimore, njoftime për studentët, afishimin e notave, kryerjes e quizeve etj.
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të	Nëpërmjet informacionit që merret nga platforma on-line, organet drejtuese dhe tirullarët e institucionit kanë mundësi të monitorojnë



aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	aktivitetin akademik dhe administrativ dhe të informohen në kohë reale mbi të gjithë aktivitetin mësimor.			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	<p>KU “IKT” publikon në faqen e saj zyrtare të internetit çdo informacion që lidhet me programet e studimit (programet e lëndëve dhe degëve), informacion mbi kriteret e pranimit, tarifat e studimit, përfitimt e bursave të studimit, personelin akademik të angazhuar në aktivitetin mësimor, si dhe çdo lloj informacioni tjetër, që ka të bëjë me aktivitetet e përditshme të Intitucionit. Faqja e internetit mund të aksesohet në dy gjuhë: shqip dhe anglisht.</p> <p>Nga një verifikim i bërë faqes së internetit, materialet ishin pothuaj në anglisht. Ekzistonte një ikonë në shqip, por kur klikon materiali është në anglisht. Madje kishte edhe mospërputhje të faqes në shqip dhe në anglisht, si për shembull tarifa e studimit (e cila ka ndryshuar vitine fundit) në anglisht është 1.500 euro, ndërsa në gjuhën shqipe tregohet 2.000 euro.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	<p>Institucioni harton një raport financiar të kostove të financimit në nivel institucioni dhe të njësisë kryesore, por jo për një program të caktuar studimi (dok. nr. 65).</p> <p>Nga vizita në institucion, GVJ iu konfirmua se për shkak të numrit të vogël të studentëve dhe meqënëse pothuaj të gjithë studentët e këtij program studimi fitojnë bursë, ky program studimi del me humbje.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	<p>Planifinanciar i paraqitur ne dok. nr. 65 (pavarësisht se nuk kuptohet cilit vit i takon), përmban të gjitha shpenzimet që bëhen në mbështetje të programeve të studimit të ofruara nga institucioni. Shpenzimet janë të evidentuara veçan për qeranë, pagat e personelit, marketingun, shpenzimet për kërkimin shkencor, inovacionin teknologjik, shpenzimet për pasurimin e literaurës, shpenzimet operative etj.</p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Kolegji Universitar “CIT” kryen çdo vit auditimin e jashtëm të gjendjes financiare nga një ekspert kontabël i autorizuar konform legjislacionit në fuqi që rregullon veprimtarinë e shoqërive tregtare.</p> <p>Në dokumentet e paraqitur nga institucioni, është përfshirë raporti i auditit vitit 2018. Në raportin e auditit përshkruhet gjendja financiare e shoqërisë, pa dhënë informacion të detajuar mbi elementët e pasqyrave financiare. Sipas raportit të Auditesit të Pavarur drejtuar aksionerëve pasqyrat financiare paraqesin drejt në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë në fund të vitit 2018.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Në tabelat bashkëngjitur RVB jepen të dhëna mbi të ardhurat e siguruara nga institucioni gjatë tre viteve të fundit (përfshirë edhe vitin në vazhdim). Të ardhurat vijnë pothuaj nga tarifat e studentëve dhe shumë pak nga sponsorizimet dhe aktiviteti tregtar.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Mbështetur në Raportin e Auditit KU «CIT» e ka mbyllur vitin 2018 me humbje, fakt i cili tregon një pasiguri materiale që mund të vërë në dyshim qëndrueshmërinë financiare në të ardhmen të shoqërisë. Sipas raportit të Auditesit, e ardhmja financiare e shoqërisë varet nga mbështetja financiare që do ti sigurojë asaj aksionerët. Po sipas këtij raporti, është marrë konfirmim nga shoqëria mëmë që të sigurojë mbështetje financiare për vitin në vazhdim. Një dokument konkret lidhur me këtë mbështetje nuk është paraqitur.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<b>X</b>	

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<b>X</b>

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<p><b>Standardi V.1</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në</p>	<p>Institucioni ne bazë të ligjit nr. 80/2015, date 22.07.2015 “Mbi Arsimin e Lartë në Shqipëri” dhe aktet e veta rregullatore, ka hartuar dhe miratuar nga Senati, rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Financë dhe Kontabilitet”. (Dok. nr. 12) Kjo rregullore përcakton aspektet organizative të programit të studimit duke filluar me pranimin e</p>

përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	studentëve në këtë program studimi, vlerësimine tyre gjatë viteve të studimit, mundësinë e transferimit dhe largimit të tyre nga programi i studimit dhe përfundimin e studimeve.			
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i dokumentacionit (rregullorja institucionale, rregullorja e programit të studimit), GVJ konstatoi se politikat dhe procedurat që ndjek KU “IKT” garantojnë barazinë dhe të drejtat e studentëve nga hyrja në dalje të tyre.			
<b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Rregullorja e programit të studimit përcakton kriteret që duhet të plotësohen nga kandidatët për studentë që kanë mbaruar shkollën e mesme, nga shtetas të huaj që dëshirojnë të kryejnë studimet në këtë program studimi, studentë që dëshirojnë të ndjekin një program të dytë studimi, si dhe transferimin e studenteve nga institucione të tjera të arsimit të lartë. Kriteret janë të qarta dhe lehtësisht të kuptueshme.  Rregullorja u vihet në dispozicion studentëve çdo vit akademik dhe çdo student është i detyruar ta zbatojë atë. Procedurat dhe kriteret që përmban rregullorja janë përfshirë në “Guidën e Studentit” e publikuar on-line në faqen e internetit të institucionit.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Nga vizita në institucion dhe bazuar në rregulloren e programit të studimit (pika 5.2) u konfirmua se Senati Akademik i KU “IKT” miraton në fillim të vitit akademik kriteret për pranimin e studentëve në ciklin e parë të studimeve Bachelor, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe rregulloret përkatëse.			
<b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit të studentëve të përcaktuara në rregulloret përkatëse hartohen në përputhje me aktet nënligjore të Ministrisë së Arsimit. Sipas nenit 6 të Rregullores së programit të studimit, për tu pranuar në programin e studimit të ciklit të parë bachelor “Financë dhe Kontabilitet” kandidati duhet të ketë përfunduar ciklin e arsimit të mesëm dhe provimet e detyrueshme të Maturës Shtetërore, si dhe të plotësojë kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të KM. Në këtë program studimi lejohet të ndjekin studime edhe kandidatë që kanë një diplomë tjetër të marrë nga një institucion jashtë vendit, por të njohur nga MAS, si dhe shtetas të huaj të cilët kanë leje qëndrimi në Shqipëri.			
<b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Sipas rregullores së programit të studimit (pika 2.5) institucioni publikon në fillim të çdo viti akademik kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit.  Këto kërkesa gjenden lehtësisht në faqen on-line të KU “IKT”.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.2</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</b>				
<b>Kriteret</b>		<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>		
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.		Kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit në tjetrin përcaktohen në rregulloren e programit të studimit, ku përcaktohen kriteret e pranimit, sistemin e vlerësimit dhe kontrollit të njohurive të studentit, mënyrën e largimit nga institucioni, frekuentimin e lëndëve, mungesat, vlerësimin dhe përlllogaritjen e tij, një informacion mbi provimet, praktikatat, diplomimin dhe informacione të tjera. Ky informacion është përfshirë në guidën e studentit e publikuar on-line në faqen e KU “IKT”.		
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.		Pika 9 e rregullores së programit të studimit u njeh të drejtën e transferimit në këtë program studimi të studentëve të institucioneve të tjera sipas kriterëve të përcaktuara në aktet rregullatore të institucionit. Studentët mund të rregjistrohen në vitin e dytë të studimeve vetëm nëse kanë marrë të paktën 30 kredite, dhe në vitin e tretë të studimeve vetëm nëse kanë marrë të paktën 90 kredite. Proçesi i njohjes së kualifikimeve të mëparshme dhe ekuivalentimit të lëndëve bëhet nga Komisioni i Njohjes dhe Ekuivalentimit (të Kurrikulës) i Departamentit të Administrim Biznesit (pika 2.4 e rregullores së programit të studimit).		
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.		Rregullorja e programit të studimit (pika 5) përmban kriteret e vlerësimit dhe kontrollit të studentëve gjatë viteve të studimit. Këto kriteret janë pasqyruar edhe në syllabuset e lëndëve me të cilat studentët njihen që oren e parë të mësimin dhe janë përfshirë edhe në Guidën e Studentit, e aksesueshme on-line në çdo kohë.		
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.		Rregullorja e programit të studimit (pika 8) dhe në mënyrë më specifike Libri i rregulloreve (kapitulli IV, pika II) dhe Manual i punimit të Diplomës (dok. nr. 15) informojnë studentët mbi procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit: planifikimin e mbrojtjes së diplomës, kriteret dhe procedurat në përzgjedhjen e tëmës dhe udhëheqësit të diplomës, kriteret që duhet të zbatohen gjatë shkrimit të diplomës mbi metodologjinë, referencat etj., si dhe proçesin e mbrojtjes së punimit të diplomës.		
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.		Në fillim të çdo viti akademik institucioni organizon takime të hapura informuese me të interesuarit për ti informuar mbi programet e studimit që ofron ky KU “IKT”. Këto takime të hapura janë zhvilluar edhe në shkolla të mesme por edhe duke i ftuar maturantët në ambjentet e institucionit në Javët e Hapura ku nxënësit e interesuar janë informuar mbi programet e studimit dhe mundësitë që ofron ky Institucion. Janëpërgatitur edhe material promovuese që shpërndahen tek të interesuarit. KU “IKT” ofron edhe kurse falas on-line për provimet e maturës – që shërben edhe si një mënyrë efektive marketingu nga ana e institucionit.		
	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>

Shkalla e përmbushjes së standardit				X
-------------------------------------	--	--	--	---

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	<p>Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve fillon që me aktivitetet promovuese që institucioni bën me maurantët gjatë Javëve dhe Seminareve të hapura, takimeve me maurantët në shkollat e tyre, ditëve ndërkombëtare, akademisë verore dhe veprimtarive të tjera promovuese.</p> <p>Me regjistrimin në programin e studimit, studentëve u jepet informacion i hollësishëm lidhur me programin e studimit nga sekretaria mësimore si dhe stafi akademik dhe ndihmësakademik. Nga takimi me studentët, GVJ iu konfirmua se në orën e parë të mësimit të çdo lënde, studentëve u prezantohet edhe syllabusi i lëndës.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Sipas RVB dhe gjatë vizitës në institucion, KVJ iu konfirmua se informacioni i programit të studimit u jepet studentëve dhe të gjithë të interesuarve në formën e broshurës. Ky informacion është i aksesueshëm edhe në faqen e internetit të KU “IKT”.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	<p>Nga takimi me studentët si dhe bazuar në dokumentin nr.43, studentët vazhdimisht informohen mbi mundësitë e punësimit dhe u ofrohet mbështetje nga institucioni për tu orientuar drejt tregut të punës. Studentët konfirmuan mbështetjen që u ka ofruar institucioni jo vetëm për të kryer praktikat sipas programit të studimit, por edhe për kryerjen e intershipeve të ndryshme gjatë vitit akademik.</p> <p>Institucioni ka ngritur Zyrën e Shërbimit me Studentët e cila ka si rol kryesor këshillimin e studentëve për mundësitë e punësimit. Ky informacion u jepet studentëve edhe nëpërmjet vizitave që ata realizojnë në institucione apo biznese të ndryshme, si edhe nëpërmjet të ftuarve nga këto institucione, që japim leksion dhe informojnë studentët mbi mundësitë e punësimit që ofron tregu i punës.</p>
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Gjatë takimit me studentët, studentët konfirmuan se mund të marrin informacion në çdo kohë nëpërmjet sekretarisë mësimore. Ky informacion mbi organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet e ndryshme jepet që në javën e parë të fillimit të studimeve në institucion, por mund të merret on-line në çdo kohë, pasi është i publikuar edhe në faqen e internetit.
<b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të	Sistemi i brendshëm i informacionit i ndërtuar mbi një platformë të realizuar nga vetë institucioni, u mundëson studentëve që të marrin

brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	informacion lidhur me programin e studimit edhe në distancë. Një pjesë e programit të semestrit të dytë të vitit akademik 2019-2020 është zhvilluar on-line, bazuar në platformën e vete institucionit, por edhe në platform të tjera si google-clasroom, etj.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.4</b>													
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b>													
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>												
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Nga vizita në insitucion por edhe në bazë të dokumentave të paraqitur, GVJ konstatoi KU “IKT” disponon dhe mban statisika vjetore për numrin e studentëve të diplomuar për çdo program studimi. Aktualisht për programin e studimit bachelor “Financë dhe Kontabilitet” nuk ka ende të diplomuar.												
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Gjatë takimit me sekretarinë mësimore, GVJ konfirmoi se institucioni nëpërmjet rregjistrave përkatës mban informacion mbi numrin e studentëve të regjistruar për herë të parë, të transferuar dhe të larguar nga program i studimit për çdo vit akademik.  GVJ verifikoi regjistrin themeltar të studentëve të regjistruar gjatë tre viteve akademike në këtë program studimi dhe konfirmon se rregjistrimet përputhen me të dhënat e paraqitura në RVB.  Nga vlerësimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.  Numri i studentëve në këtë program studimi ka qenë në tre vitet e fundit si më poshtë:												
	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Të regjistruar</th> <th>Të c’regjistruar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2017-2018</td> <td>8</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>2018-2019</td> <td>10</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>5</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Viti akademik	Të regjistruar	Të c’regjistruar	2017-2018	8	2	2018-2019	10	1	2019-2020	5	
Viti akademik	Të regjistruar	Të c’regjistruar											
2017-2018	8	2											
2018-2019	10	1											
2019-2020	5												
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	Sekretaria mësimore rregjistron informacionin mbi ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi i tyre deri në diplomimin e tyre. Në bazë të Statutit të KU “IKT”, institucioni është i detyruar të mbajë tre rregjistra: a) regjistrin themeltar të studentëve; b) regjistrin e arritjeve akademike; c) regjistrin e lëshimit të diplomave dhe çertifikatave.												

	GVJ verifikoi dy regjistrat e parë, meqënëse regjistri i diplomave nuk është krijuar ende për këtë program studimi, dhe verifikoi se evidentonin ecurinë e të gjithë studentëve nga pranimi dhe deri në përfundim të semestrit të parë, viti i tretë.			
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve arkivoheshin dhe ishin lehtësisht të verifikueshme nga persona të autorizuar. Sipas RVB informacioni për çdo program studimi është i ruajtur në hard copy dhe në mënyrë elektronike. Databaza elektronike është e ruajtur dhe e siguruar, sipas elementëve të sigurisë nëpërmjet sistemit të backup.  Detyrat e sekretarisë mësimore dhe zyrës së arkivit janë të përcaktuara në rregulloret përkatëse, të miratuara nga Senati Akademik.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Në fund të çdo viti akademik, institucioni bën një analizë mbi profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje të studentëve. Sipas dokumentave të paraqitur në dosjen e RVB studentët kanë hyrë me një mesatare nga 8,4 në 8,9, ndërkohë që nuk është llogaritur ende mesatarja e notave në përfundim të studimeve (meqënëse nuk ka mbaruar ende viti akademik).  Raporti i vlerësimit të programit të studimit (dok. nr. 59) i paraqitur nga institucioni, bën një analizë të ecurisë së studentëve, për sa i përket numrit të studentëve të rregjistruar, të larguar dhe atyre ekselentë, por nuk jep një informacion më të detajuar mbi ecurinë e tyre vit pas viti. Gjithsesi në fund të raportit jepen edhe disa vlerësime dhe sugjerime se çfarë duhet të bëhet në vazhdim.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Statuti i KU "IKT" (neni 98) sanksionon të drejtën e studentëve për të marrë pjesë në proceset e vendimarrjes së Kolegjit dhe neni 99 sanksionon të drejtën e studentëve në këshilla studentore apo qeveri studentore, sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me	Sipas "Librit të Rregulloreve Institucionale" pika 3, studentëve u jepet e drejta të përfshihen në organet vendimmarrëse të kolegjit si: Senati Akademik, Këshillat e Fakulteteve, Këshilli i Etikës dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ndërsa pika 4 e Rregullores u jep të drejtën e krijimit të Qeverisë Studentore. Gjithashtu sipas RVB studentët marrin pjesë edhe në komisione apo komitete të tjera si: Komiteti i

<p>rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Bursave, Komiteti Permanent për Çështjet e Studentëve dhe Garantimin e të Drejtave të tyre, Komiteti Permanent për Programet dhe Kurrikulat. Me qëllim që të rritej përfshirja e studentëve në vendimarrje dhe këshillim, me propozim të studentëve, Senati Akademik në fillim të vitit 2019 vendosi të rritë numrin e përfaqësuesve të studentëve nga një në tre (dok. nr. 61). Angazhimi i studentëve në këto organe është konfirmuar edhe nga studentët gjatë takimit me grupin e GVJ.</p> <p>Studentët e programit bachelor “Financë dhe Kontabilitet” kanë organizuar edhe grupin “Finance Club” nëpërmjet të cilit kanë organizuar aktivitete të ndryshme sociale, kulturore dhe humanitare. Për këto organizime, gjatë takimit me GVJ studentët janë shprehur se kanë patur mbështetjen dhe përkrahjen e plotë të institucionit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>GVJ konstatoi se programet e studimi janë hartuar duke mbajtur parasysh ngarkesën akademike të studentëve në këtë program studimi. Ngarkesa akademike e studentëve është e shpërndarë në mënyrë uniforme gjatë të tre viteve akademike dhe aktet rregullotare të institucionit njohin studimet dhe kualifikimet e mëparshme të studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Pika 4 e “Librit të rregulloreve Institucionale” përcakton dhe rregullon mënyrën e përfshirjes së studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, nëpërmjet organizimit të tryezave të rrumbullakta me studentët për të mbledhur opinionet e tyre lidhur me kurrikulat, tekste të mësimorë si dhe përmbajtjen dhe cilësinë e kurrikulave, cilësinë e procesit të mësimor, metodat e mësimdhënies, komunikimin me pedagogët, efektivitetin e mësimdhënies, cilësinë e leksioneve dhe seminareve etj; takimeve të drejtuesve të institucionit me studentë dhe përfaqësuesit e tyre; apo plotësimit të pyetsorëve të vlerësimit të programit dhe të pedagogëve.</p> <p>Qeveria Studentore e KU “IKT” sipas pikës 5 të “Librit të Rregullores Institucionale” dhe RVB promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet qeverisëse të Institucionit, në strukturat mësimdhënëse dhe të kërkimit shkencor. Një përfaqësues i studentëve është edhe pjesë e grupit të punës së RVB për këtë program studimi.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit bachelor “Financë dhe Kontabilitet” (neni 5.4) dhe Libri i rregulloreve Institucionale (Kapitulli VII) mundësojnë transparencën, barazinë dhe objektivitetin në vlerësimin e procesit të kontrollit të dijeve, duke u dhënë të drejtën e ankimimit studentëve si dhe nëpërmjet përcaktimit të procedurës që ndiqet nga institucioni në këtë rast. Pasi ezauron procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës, studenti ka të drejtë të drejtohet me shkrim Përgjegjësit të departamentit i cili ngre një komision për rishikimin e provimit, vendimi i të cilit është përfundimtar.</p>



	Nga takimi me studentët, GVJ iu konfirmua se ata ishin sqaruar për rezultatet me lektorin përkatës, pa qenë e nevojshme të kalonin në procedurat e mëtejshme të rishikimit të rezultatit të provimeve.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Në përputhje me aktet ligjore, KU “IKT” ka ngritur zyrë të posaçme në shërbim të studentëve. Libri i rregulloreve institucionale (kapitulli VIII) rregullonmënyrën e funksionimit të “Zyrës së marketingut dhe shërbimit ndaj studentëve”. Për të mundësuar një përfshirje dhe shërbim më të mirë ndaj tyre, në vitin akademik 2019-2020 është bërë një ndryshim në strukturën administrative, duke shtuar në të postin e Koordinatorit të Marrëdhënieve me Studentët.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Detyra e Koordinatorit të marrëdhënieve me studentët është edhe informimi, këshillimi, ndjekja e përparimit të studentëve dhe asistimi i tyre për çështje që kanë të bëjnë me aktivitetin mësimor dhe programin e studimit. Gjithashtu në institucion funksionon edhe tutoriati akademik, ku një pedagog merr përsipër këshillimin dhe asistimin e një numri të caktuar studentësh. Gjatë takimit me studentët, GVJ konstatoi se studentët preferonin më shumë komunikimin me pedagogët për informimin apo zgjidhjen e problemeve që mund tëkishin dhe studentët nuk ishin shumë të familjarizuar me këtë zyrë.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Departamenti i Administrim Biznesit, në bashkëpunim me zyrën e shërbimit të studentëve, këshillon dhe orienton studentët lidhur me përzgjedhjen e institucionit për zhvillimin e praktikës profesionale. Për qëllime të zhvillimit të praktikës profesionale, institucioni ka lidhur marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të ndryshmePër këtë qëllim studentët kanë bërë vizita në këto institucione, si dhe kanë ndjekur leksione të përfaqësuesve të këtyre institucioneve në ambientet e KU “IKT”.
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Në nivel institucioni është krjuar struktura Alumni, e përfshirë në zyrën e shërbimit ndaj studentëve. Qëllimi i kësaj zyre është krijimmi i rjetit të studentëve të diplomuar në këtë institucion duke mbajtur kontakte të vazhdueshme me ta. Ka patur organizime, takime të realizuara në kuadër të Alumni (dok. nr. 55,4), të cilat sipas drejtuesve të institucionit kanë qënë shumë efikase si tregues për të vlerësuar ecurinë e studentëve pas diplomimit si dhe në shkëmbimin e eksperiencave, prezantim të

	kërkesave të tregut të punës, identifikim i risive, që kërkon tregu lidhur edhe me kurrikulat, praktikat, literaturën, etj.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore ku “IKT” ka ngritur sistemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili mundësohet nëpërmjet akteve të ndryshëm rregullatorë të institucionit si: Statuti, Rregullorja Insitucionale, Manuali i Sigurimit të Cilësisë (QAU Handbook), Rregullorja për Organizimin dhe Funksonimin e NJSBC.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	“Manuali i Sigurimit të Cilësisë” është dokumenti bazë që rregullon në detaje funksionimin e Sistemit të Brendshëm të Cilësië. Manuali gjendet edhe online në faqen e ëeb të IKT dhe është i aksesueshëm prej stafit akademik në çdo kohë. Ai përcakton komponentët dhe parimet mbi të cilat mbështetet sistemi i sigurimit të cilësisë në institucion, strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë, procedurat për sigurimin e cilësisë në institucion, dhe për vlerësimin e programeve të studimit. Përfshirja e studentëve në vendimarrje është një nga parimet në të cilën bazohet sistemi i sigurimit të cilësisë në institucion, e përcaktuar në Manualin e Sigurimit të Cilësisë.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	KU “IKT” ka ndjekur procedurat dhe ka përdorur instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit. Ky institucion është akredituar fillimisht në vitin 2016, përmes Urdhërit të MAS, Nr. 139, datë 25.03.2016, dhe ne vitin 2017 është akredituar institucionalisht edhe në vitin 2017, duke marrë “Certifikatën e Akreditimit” prej Bordit të Akreditimit të ASCAL, sipas vendimit të këtij bordi Nr. 116, datë 15.12.2017, për një periudhë 5 vjeçare. Gjithashtu ka ndjekur edhe procedurat e nevojshme për akreditimin e programeve të studimit që ofron.

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>KU “IKT” ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve. Krijimi i kulturës së sigurimit të cilësisë është një nga parimet e përcaktuara në Manualin e Sigurimit të Cilësisë dhe sipas RVB shfaqet në disa komponentë të rëndësishëm të jetës së institucionit, si psh: - Transparenca e shumë veprimtarive, përmes faqes së internetit dhe social-medias; Përfshirja e studentëve në organet vendimmarrëse; Punimi i rregullorëve dhe manualëve, sipas metodologjisë dhe kërkesave ndërkombëtare; Hartimi, përdorimi dhe analizimi i pyetësorëve prej një periudhë shumë të gjatë kohore, prej disa vitesh akademike në programe të ndryshme studimi; Hartimi modeleve dhe procedurave të ndryshme në shërbim të stafit akademik dhe studentëve; Përpunimi i të dhënave të mbledhura si nga pyetësorët, vetvlerësimet apo dhe nga Alumni; publikimi në faqen on-line të institucionit të të dhënave më të rëndësishme për studentët; ruajtja e një stafi të angazhuar për akreditimin dhe pjesë të NJSBC prej shumë vitesh, që bashkëpunon dhe shkëmben informacion etj.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi VI.2</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Në bazë të parashikimeve ligjore dhe nënligjore dhe akteve rregullatore institucionale në vitin 2013 është ngritur “Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë”.</p> <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është përgjegjëse për zhvillimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e cilësisë së brendshme në institucion.</p> <p>Kompetencat e NJSBC dhe të Komitetit përcaktohen në Manualin e Sigurimit të Cilësisë. NJSBC përbëhet nga pesë anëtarë, nga të cilët një është përfaqësues i Këshillit Studentor.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Manuali i Brendshëm i Cilësisë përcakton edhe mekanizmat dhe proceset që ndiqen në rast hapje të një program të ri, shtimin e një lënde të re, rishikimin e kurrikulave të programit të studimit si dhe ndërprerjes së programeve të studimit. Për programin e studimit në bachelor në “Financë dhe Kontabilitet” nuk janë bërë ndryshime, pasi pritet që të akreditohet dhe më pas të bëhen ndryshimet e nevojshme dhe të sugjeruara nga procesi i vlerësimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe</p>	<p>Sipas RVB monitorimi i procesit të cilësisë së programeve ndiqet prej NJSBC, e cila përdor mekanizma të tillë si pyetësorë të studentëve, vetvlerësime, raporte institucionale, ndjekja e punësimit, etj. Ndërkaq,</p>

mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	monitorimi i ecurisë së programit bëhet prej njësisë bazë, që për të kryer këtë funksion përdor instrumente të tilla si ndjekjen e procesit mësimor, cilësinë e studentëve në hyrje-dalje, kalueshmërinë, mbetjet, punësimin, etj.			
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Sipas RVB dhe nga vizita në institucion, GVJ iu konfirmua se njësi bazë që ofron programin e studimit së bashku me NJSBC dhe sekretarinë bashkëpunojnë për të mbledhur të dhënat e domosdoshme, të cilat shërbejnë për vlerësimin e programit. Të gjitha të dhënat statistikore, cilësore apo dhe analitike përmbledhen në një raport të vlerësimit të programit të studimit. Të gjitha politikat që vihen në shërbim për të siguruar cilësinë e proceseve akademike, ndryshimet apo dhe rishikimet e kurrikulave dhe objektivave të tyre, pasi analizohen në njësitë bazë, propozohen në organet kolegjiale si Senati Akademik këshillat e fakulteteve, dhe ndjekin vendimmarrjen.			
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Raporti i vlerësimit i programit Bachelor në “Financë dhe Kontabilitet” (dok. nr. 59), është vlerësuar në Shtator-Tetor 2019 prej Departamentit Administrim Biznesit. Raporti i vlerësimit të programit të studimit bachelor në “Financë dhe Kontabilitet” (dok. nr. 59) i paraqitur nga institucioni, bën një analizë të ecurisë së studentëve, për sa i përket numrit të studentëve të regjistruar, të larguar dhe atyre ekselentë, por nuk jep një informacion më të detajuar mbi ecurinë e tyre vit pas viti. Gjithsesi në fund të raportit jepen edhe disa vlerësime dhe sugjerime se çfarë duhet të bëhet në vazhdim.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësi e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	NJSBC angazhohet që të kryejë në mënyrë periodike vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit. Rezultatet e raporteve të vlerësimit të programit përdoren nga institucioni në kuadër të akreditimit dhe të vetëvlerësimit periodik të brendshëm.  Në bazë të Manualit të Brendshëm të Cilësisë (Kapitulli II) çdo vit duhet të bëhet vlerësimi i paktën gjysmës së lëndëve, ndërsa vlerësimi i programit të studimit duhet të bëhet të paktën një herë në pesë vjet.  Gjatë takimit me NJSBC, GVJ iu konfirmua se vlerësimi i lëndëve nëpërmjet pyetsorëve të studentëve bëhet çdo fund semestri para provimit përfundimtar, ndërsa vlerësimi i programit të studimit bachelor në “Financë dhe Kontabilitet” është bërë në tetor-nëntor 2019 dhe pritet të bëhet në përfundim të tij, në mënyrë që të merret një informacion më

	i plotë mbi ndryshimet që mund të bëhen në këtë program që është në process akreditimi.			
<b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	KU “IKT” përdor metoda e instrumente te ndryshme për vlerësimin e ecurisë dhe mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies, cilësisë së literaturës së përdorur, teknikave pedagogjike të përdorura nga pedagogët etj. si dhe për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit. Aktiviteti i monitorimit organizohet nga NJSBC, për secilin nga proceset akademike, që kontrollohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raportohen Senatit, Rektoratit dhe Dekanateve të fakulteteve. Metodologjia e vlerësimit mbështetet mbi vlerësimin me pyetsor dhe vetdeklarimin. Ndërsa, instrumentët për ta arritur këtë gjë kanë qenë pyetësorët në rastin e studentëve dhe në rastin e stafit akademik e administrativ, pyetësorët dhe vetvlerësimi. Përmes raportimit, vetvlerësimit dhe pyetësorëve të kryer janë marrë të dhëna të rëndësishme mbi ecurinë e proçeseve brenda institucionit.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.	Pyetësorët janë organizuar në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit, për të gjitha ciklet, për të gjitha lëndët dhe pedagogët. Kontrolli i brendshëm i cilësisë me anë të pyetësorëve ka analizuar përmbajtjen dhe zbatimin e programit të lëndëve si dhe cilësinë e mësimdhënies. Kryesisht, pyetësorët e zhvilluar nga institucioni janë përqëndruar në: - Vlerësimin e stafit nga studentët - Vlerësimin e studentëve për programet dhe lëndët - Vlerësimin e studentëve për literaturën e përdorur - Vlerësimin e stafit për institucionin, shërbimet që ai ofron për stafin dhe organet drejtuese.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ iu konfirmua se stafi akademik dhe organet drejtuese ishin të hapur për mendimet dhe opinionet e studentëve në çdo kohë, si gjatë orëve të proçesit mësimor por edhe duke realizuar dëgjesa dhe tryeza të rrumbullakta. Praktikë e këtij institucioni, ishte që gjatë intervistët aplikantët për pedagogë ftoheshin të mbanin një leksion të hapur, për të vlerësuar aftësinë mësimdhënëse të tyre. Për programe të akredituara dhe ku institucioni ka diplomuar studentë janë zhvilluar edhe takime me ALUMNI, tryeza të rrumbullakta si dhe pyetësorë, apo anketime për të tërhequr mendimin e tyre në lidhje me institucionin si dhe programin ku ata janë diplomuar.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se drejtuesit e institucionit ishin të gatshëm për të përfshirë në politikat dhe procedurat e vlerësimit të cilësisë aktorë të brendshëm dhe të jashtëm, nëse ishin të ineresuar. Për sa i përket aktorëve të brendshëm (stafit dhe studentëve) ata janë tëangazhuar edhe në strukturat e ngritura për sigurimin e brendshëm të cilësisë por edhe nëpërmjet instrumenteve që përdoren për vlerësim. Ndërsa për përfshirjen e aktorëve të jashtëm të interesuar, instutucioni ka organizuar një anketim me maturantë, për të vlerësuar se sa përputhen interesat dhe pritjet e tyre me programet e ofruara nga kolegji, si dhe një anketim me student të diplomuar për të vlerësuar se sa diploma e përfituar në këtë institucion i përgjigjet nevojave të tregut.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Manual i Brendshëm i Cilësisë përcakton strukturat përgjegjëse të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Si strukturë kryesore është NJBSC, por duhet të angazhohen edhe të gjitha organet drejtuese të institucionit.
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	NJBSC është e ngritur në nivel institucioni, por anëtarët e saj janë pesonel nga të dy fakultetet si dhe përfaqësues nga studentët. Në çdo vlerësim, NJBSC bashkëpunon me njësinë përkatëse kryesore dhe bazë dhe personelit përkatës të tyre. Manual i Brendshëm i Cilësisë në vlerësimin e programeve dhe kurseve të reja përcakton detyrat dhe palët që janë përgjegjëse, kontribuese dhe aprovuese për secilën detyrë. Në kët proces përfishen si organet drejtuese, edhe stafi akademik edhe studentët.
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Nga shqyrtimi i dokumenteve dhe nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se rregullimi me rregullore i procesit të vlerësimit respekton integritetin akademik dhe shmang mundësinë e diskriminimit apopabarazisë si ndaj personelit akademik edhe ndaj studentëve.
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Sipas RVB, KU “IKT” nuk ka angazhuar ekspertë të jashtëm në procesin e vlerësimit të programeve dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë sepse sikurse u bë me dije gjatë takimit nuk e kanë parë të nevojshme. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë janë bërë bashkëpunëtorë të ndryshëm, që përmes tryezave, seminareve dhe aktiviteteve, që janë organizuar kanë shprehur mendimet e tyre për ecurinë e programeve. Gjatë vizitës në institucion, GVJ iu konfirmua se institucioni mban kontakte të vazhdueshme me të diplomuarit në këtë universitet, mendimet dhe sugjerimet e të cilëve janë shumë të vlefshme për përmirësimin e kurrikulave dhe programeve të studimit në këtë kolegji.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ gjatë shqyrtimit të dokumenteve konstatoi se politika, strategjia, organizimi dhe aktivitetet në lidhje me sistemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.  Informacioni mbi NJBSC, përbërjen e saj, detyrat dhe funksionet që kryen, Manuali i Brendshëm i Cilësisë dhe rezultatet e përpunuar të pyetësorëve janë të aksesueshëm në faqen on-line të KU “IKT” nga çdo palë e interesuar.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Proçesi i publikimit të rezultateve të programeve të studimit bëhet në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike. Publikimi i këtyre të dhënave është konform ruajtjes së privacisë si dhe brenda etikës institucionale duke mos shkelur parimet e konfidencialitetit, integritetit dhe fshehtësisë, të saknksionuara edhe në rregulloret e miratura nga institucioni në Librin e Rregulloreve Institucionale: “Mbi mbrojtjen e të dhënave personale” dhe “Rregullat e procedurat e informimit publik”. Informacionet e publikuara janë të përgjithshme, pa specifikuar emra dhe nuk çenojnë informacionet konfidenciale. Informacioni plotë, me emra të specifikuar, mbi rezultatet e proçesit të vlerësimit u dergohet organeve drejtuese (dekanë dhe rektor) që kanë të drejtë akses në to si dhe palëve të interesuara.
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Qëllimi i sistemit të vlerësimit të brendshëm, siç përcaktohet edhe në Manualin e Brendshëm të cilësisë, është përmirësimi i cilësisë të aktivitetit mësimor lidhur me kurrikulat dhe programet e studimit. Gjatë takimit me pedagogët dhe NJBSC, GVJ iu konfirmua se në disa raste programet e tjera janë rishikuar apo janë marrë masa korrigjuese me qëllim përmirësimin e programeve të studimit. Për sa i përket programit të studimit Bachelor në “Financë dhe Kontabilitet”, sikurse e kemi shpjeguar edhe më sipër, nuk është shumë i detajuar si për sa i përket vlerësimit, por edhe masave që duhen marrë. Sipas RVB por edhe gjatë vizitës në institucion, GVJ iu konfirmua se pritet akreditimi në mënyrë që të mund të bëhen ndryshime në program në varësi të vlerësimeve të kryera.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstatoi se vlerësimit të brendshëm të cilësisë i jepet rëndësia dhe serioziteti i duhur nga të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proçes, duke filluar nga studentët, stafi akademik dhe ndihmës dhe deri tek organet drejtuese. Gjatë takimit me studentët dhe stafin, u theksua fakti se ky ishte një proçes me ndikim pozitiv në veprimtarinë e tyre akademike për përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit.

<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Rezultatet e procesit të vlerësimit, përveç publikimit në faqen on-line të institucionit, diskutohen vazhdimisht me studentët dhe me stafin akademik dhe ndihmës, në mënyrë që ata të ndërgjegjësohen për rëndësinë që ai ka për përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Financë dhe Kontabilitet”, të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Programi ofrohet në gjuhën angleze që u jep mundësi studentëve të studiojnë literaturë bashkëkohore në gjuhë të huaj dhe të jenë të përgatitur për vazhdimin e studimeve të mëtejshme edhe në vende të tjera apo për të punuar në tregun e huaj të punës.
2. Programi i studimit aplikon vlerësimin e vazhdueshëm gjatë vitit në një shpërndarje të larmishme mes formave të testimit me shkrim, prezantimeve, kuizeve, etj, cka në total lehtëson mësimnxënien dhe rezultate pozitive.
3. Institucioni ka një vendodhje në qendër të qytetit, e aksesueshme lehtësisht nga studentët dhe stafi i institucionit dhe palët e interesuara
4. Institucioni zbaton një sistem efektiv dhe të qëndrueshëm të sigurimit të brendshëm të cilësisë për rritjen e cilësisë së programeve të studimit.

**Pika të dobta:**

1. Informacioni i paraqitur në faqen on-line është i plotë dhe i mjaftueshëm për të gjitha palët e interesuara, por është pothuaj në gjuhën angleze. Madje ka edhe mospërputhje midis informacionit në gjuhën shqipe dhe atij të gjuhën angleze.
2. Institucioni nuk aplikon mjaftueshëm politika të nxitjes aktive të angazhimit të personelit në fushën e kërkimit shkencor apo në trajnime me karakter pedagogjik dhe akademik. Gjithashtu Institucioni nuk ofron mbështetje të mjaftueshme financiare apo stimuj financiarë për kualifikimin e mëtejshëm të stafit apo stimuj të bazuar në performancë.



3. Përmbajtja e programit të studimit reflekton disa mbivendosje të njohurive mes lëndëve të financës; gjithashtu konstatohen disa mungesa në njohuritë e nevojshme në fushën e kontabilitetit për specifika të realitetit shqiptar.
4. Pjesëmarrja dhe angazhimi i Institucionit, dhe në vecanti i këtij programi studimi, në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare është ende modest dhe vetëm në hapat e tij të parë.
5. Programi i studimit nuk ka arritur të kryejë një analizë të plotë dhe tërësore të ecurisë së tij gjatë tre viteve të para dhe mungojnë rezultatet e thelluara që do të mundësonin reflektimin e përmirësimeve të mundshme të programit.

### **Rekomandime:**

1. Të rishikohet faqja on-line e institucionit: Të gjitha materialet që postohetë përkthehen në gjuhën shqipe dhe të korigjohen disa mospërputhje midis materialeve në dy gjuhët.
2. Të shtohen kualifikimet dhe trainimet profesionale të stafit akademik dhe atij ndihmës. Institucioni duhet të përfshihet dhe të japë kontributin e tij në këtë drejtim, duke mos e lënë në dorë vetëm të stafit.
3. Meqenëse u konstatua se një pjesë e lëndëve që i përkasin fushës së financës kanë mbivendosje të disa koncepteve sugjerohet të rishikohen programet e lëndëve të fushës së finances. Gjithashtu rekomandojmë zëvendësimin me një lëndë tjetër të lëndës “Metodat e kërkimit në Financë” sepse nuk përshtatet me programin e ciklit të parë të studimeve, si edhe të pasurohen temat e fushës së kontabilitetit dhe raportimit financiar dhe tatimor, me njohuri specifike në këto disiplina për realitetin shqiptar.
4. Të shihet mundësia e përfshirjes në projekte që institucioni të sigurojë vetë të ardhura të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve, në mënyrë që të mënjanohet varësia nga kontributet e aksionarëve.
5. Institucioni duhet të angazhohet në një punë më kërkuese dhe të thelluar gjatë analizës së mbarëvajtjes së programit të studimit në mënyrë që të kuptojë pikat e dobëta dhe mungesat e programit si edhe të mund të identifikojë lehtësisht mundësitë për përmirësim në të ardhmen.

### **Conclusion of assessment process for the Study Program “Bachelor in Finance and Accounting” offered from the University College “Canadian Institute of Technology”**

#### **Strengths:**

1. The Study Program, Bachelor in Finance and Accounting offered by the Canadian Institute of Technology is delivered in English language, what provides for its students the opportunity to study contemporary and updated literature from distinguished foreign authors and to be prepared to continue their studies in other countries or to work in the foreign labor market.
2. The study program is based on a continuous assessment process throughout the academic year applying a diverse distribution among written test, case presentations, quizzes, etc., which overall facilitates the learning process and helps students attain more positive results.

3. The location of the Institution is in the city center and is easily accessible by students and staff of the institution and various stakeholders.
4. The institution implements an effective and sustainable system of internal quality assurance with the final aim to increase the quality of this study program.

### **Weaknesses:**

1. The information presented on the website of the Institution is complete and sufficient for all interested parties, but it is almost all in English language. There are even discrepancies between the information provided in the Albanian language and that provided in the English language.
2. The institution does not apply sufficient and adequate policies to actively promote the engagement of its staff in the scientific research and projects and neither does it offer enough trainings of pedagogical and academic character. Furthermore the Institution does not provide appropriate financial support or financial incentives for advanced staff qualification or performance-based incentives.
3. The content of the study program contains several overlaps of some concepts and technical details in the courses of the finance disciplines; There are also some shortcomings in the required knowledge and concepts that students are supposed to possess regarding the field of accounting especially in the contexts of the specifics of the Albanian reality.
4. The participation and engagement in national and international projects of the Institution in general, and in particular for this study program, is still moderate and only in its first beginnings.
5. The study program has not managed to conduct a full and thorough analysis of its progress during the first three years and lacks in-depth results that would enable the reflection of possible improvements of the program.

### **Recommendations:**

1. The experts recommend the Institution to review the website: All the materials that are posted should be translated into the Albanian language and the discrepancies between the materials in both languages should be corrected.
2. To increase the qualifications and professional trainings of the academic and support staff. The institution should be actively involved and give its contribution in the qualifications and trainings and not delegate this responsibility to its staff only.

3. Since it was revealed that some of the subjects in the finance field have overlaps regarding some concepts, it is suggested to review the contents of some of the finance subjects and courses. Experts also recommend replacing the course "Research Methods in Finance" with another course because it does not fit with the program of the first cycle of studies; experts also recommend to expand the contents in the field of accounting and financial & tax reporting, with topics of specific knowledge in these disciplines consistent with the Albanian reality.
4. The Institution should consider the possibility of being involved in projects so that it may generate diversified revenues and to cover expenses, in order to eliminate its current strong dependence on shareholder capital contributions.
5. The institution should engage in a more demanding and a thorough analysis of the progress of the study program in order to better understand the weaknesses and shortcomings of the program as well as to be able to easily identify opportunities for improvement in the future.

### Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>